



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 164

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 16 nëntor 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 10927, datë 5.11.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	11105
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 669, datë 7.11.2018	Për miratimin e procedurave, të kriterëve të vlerësimit dhe afateve të njoftimit për përzgjedhjen e kandidaturave për t'u emëruar në pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Statistikave”.....	11105
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 670, datë 7.11.2018	Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave.....	11107
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 7.11.2018	Për ngritjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën.....	11110
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 672, datë 7.11.2018	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Qeverisë së Mbretërisë së Suedisë dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, si dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë, në lidhje me dhënien e mbështetjes së shtetit pritës për ekzekutimin e operacioneve/stërvitjeve dhe aktiviteteve ushtarake të ngjashme të NATO-s dhe notës së pranimit për t'u bërë pjesë e tij.....	11111
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 674, datë 7.11.2018	Për një shtesë në vendimin nr. 1128, datë 5.8.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, të ndryshuar.....	11120
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 675, datë 7.11.2018	Për disa shtesa në vendimin nr. 511, datë 10.6.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Nyja lidhëse Milot–Lezhë, Milot–Rrëshen dhe Milot–Thumanë”.....	11121

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 676, datë 7.11.2018	Për miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane” (truall), të pasurive me numër 265/40, zona kadastrale 2702, Bashkia Vau i Dejës, numër 121/12, zona kadastrale 2375, Bashkia Durrës, dhe numër 355/47 e 355/51, zona kadastrale 3196, Bashkia Roskovec.....	11123
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 764, datë 2.11.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 542, datë 21.7.2010, “Kriteret specifike që duhet të plotësojnë subjektet e specializuara për pajisjen me autorizim për përdorim civil të lëndëve plasëse”.....	11132
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 224, datë 26.10.2018	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2019.....	11133
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 225, datë 26.10.2018	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a., për disa ndryshime në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.....	11135
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 226, datë 26.10.2018	Mbi licencimin e shoqërisë “Ener Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	11136
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 227, datë 26.10.2018	Mbi licencimin e shoqërisë “Ener Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	11137
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 228, datë 26.10.2018	Mbi licencimin e shoqërisë “Osoja HPP” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Osojë”, me fuqi të instaluar 1952 kw, në zonën e Moglicës, Korçë (lumi Osojë).....	11138
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 229, datë 26.10.2018	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për shërbimin e transmetimit të gazit natyror nr. 116 prot., datë 2.10.2018, të lidhur ndërmjet shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe shoqërisë “Albpetrol” sh.a.....	11140
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 230, datë 26.10.2018	Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SGD Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ndërfushas”, me fuqi të instaluar 1125 kw, me vendndodhje në zonën e Bulqizës.....	11141
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 233, datë 2.11.2018	Mbi fillimin e procedurës për disa amendime për propozimin e të gjitha OST-ve, mbi “Udhëzuesin për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë, në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP).....	11142
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 234, datë 2.11.2018	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin tetor 2018.....	11143

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 235, datë 2.11.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 196, datë 30.8.2018, “Për një ndryshim në vendimet e Bordit të ERE-s, nr. 120, datë 4.6.2018, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit të investimeve për vitin 2018, të shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a.” dhe nr. 121, datë 4.6.2018, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a.”.....	11145
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 236, datë 2.11.2018	Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 179, datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë operatori i kombinuar i gazit natyror ‘Albgaz’ sh.a.”.....	11146
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 237, datë 2.11.2018	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe të ngarkesës, në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, të datës 26 shtator 2016, ‘Për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë”.....	11147
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 238, datë 2.11.2018	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit, në përputhje me nenet 67 (1) dhe 70 (1), të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485, të datës 2 gusht 2017, “Për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”.....	11148
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 239, datë 2.11.2018	Mbi rishikimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.....	11150
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 240, datë 2.11.2018	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	11155
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 9287/11, datë 12.11.2018	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti, “Ndërtimi i rrugës që lidh rrugën ‘Don Bosko’ me rrugën ‘Egnatia’”, Tiranë.....	11156
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 9954/5, datë 12.11.2018	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti, “Rikualifikim urban i sheshit në fshatin Samaticë”, Ura Vajgurore.....	11158

**DEKRET****Nr. 10927, datë 5.11.2018****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:**Neni 1**

I jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tij, personit të mëposhtëm:

Jeanine Eliane Marize Sylviane Raoul Eucher
Goutran Girault (Muselier)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

VENDIM**Nr. 669, datë 7.11.2018****PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE, TË
KRITEREVE TË VLERËSIMIT DHE
AFATEVE TË NJOFTIMIT PËR
PËRZGJEDHJEN E KANDIDATURAVE
PËR T’U EMËRUAR NË POZICIONIN
“DREJTOR I PËRGJITHSHËM I
INSTITUTIT
TË STATISTIKAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 16, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikën zyrtare”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidaturave për t’u emëruar në pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT-it”, duke u mbështetur në kriteret tërësisht profesionale, me qëllim sigurimin e drejtimit të Institutit të Statistikave në mënyrë profesionale, të pavarur dhe me integritet.

2. Përzgjedhja e kandidaturave për Drejtorin e Përgjithshëm kryhet nëpërmjet zbatimit të

procedurave të hapura dhe publike të konkurrimit, nga Këshilli i Ministrave, bazuar në pikën 3, të nenit 16, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikën zyrtare”.

3. Për kryerjen e procedurës së përzgjedhjes, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave ngre komisionin *ad-hoc*, “Komisioni i Posaçëm i Vlerësimit të Kandidaturave (KPVK)”, i cili përbëhet nga tre anëtarë, si më poshtë vijon:

a) 1 përfaqësues nga Kryeministria, i cili është edhe kryetar i KPVK-së;

b) 1 përfaqësues nga Banka e Shqipërisë;

c) 1 përfaqësues nga personeli akademik i Fakultetit të Ekonomisë, në Universitetin e Tiranës.

4. Anëtarët e KPVK-së caktohen nga titullarët e institucioneve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, sipas kërkesës së paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave dhe në përputhje me pikën 5, të këtij vendimi, të paktën 10 (dhjetë) ditë përpara publikimit të shpalljes për konkurrim nga Kryeministria, sipas pikës 6, të këtij vendimi.

5. Anëtarët e KPVK-së duhet të plotësojnë këto kriteret:

a) Të kenë mbaruar arsimin e lartë dhe të zotërojnë një diplomë të nivelit, të paktën, master shkencor;

b) Për anëtarët përfaqësues të Kryeministrisë dhe Bankës së Shqipërisë, të kenë punuar për jo më pak se 5 (pesë) vjet, të paktën, në nivel të mesëm drejtues dhe të kenë njohuri në fushën e statistikave;

c) Për anëtarin përfaqësues të Fakultetit të Ekonomisë, në Universitetin e Tiranës, të ketë jo më pak se 5 (pesë) vjet përvojë pune dhe të ketë gradë shkencore;

ç) Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;

d) Të mos kenë qenë anëtarë të partive politike për 3 (tri) vitet pararendëse, nga data e caktimit si anëtar i KPVK-së;

dh) Të mos kenë qenë të dënuar penalisht me vendim gjyqësor të formës së prerë;

e) Të mos jenë larguar nga detyra si rrjedhojë e masave disiplinore.

6. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave shpall vendin e lirë për pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT-it” jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj, nga data e përfundimit të mandatit të tij në detyrë, në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqet zyrtare elektronike të



Kryeministrisë dhe INSTAT-t, deri në përfundimin e afatit të dorëzimit të dokumenteve nga aplikantët.

Në rastet e lirimit nga detyra për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 6, të nenit 16, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikën zyrtare”, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave shpall vendin e lirë për pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT-it brenda 5 (pesë) ditëve, nga data e krijimit të vendit të lirë.

7. Shpallja e konkurrimit për vendin e lirë përmban të dhënat, si më poshtë vijon:

- a) Një përshkrim të shkurtër të natyrës së punës dhe funksionit që do të mbulojë;
- b) Listën e kriterëve të pranimit;
- c) Listën e dokumenteve, që duhet të paraqiten;
- ç) Vendin ku duhet të paraqiten dhe afatin deri kur do të paraqiten dokumentet;
- d) Datën kur do të shpallet lista e kandidatëve, që do të kualifikohen për fazën e testimit;
- dh) Datën dhe vendin e zhvillimit të testimit;
- e) Mënyrën e njoftimit e të komunikimit me palët;
- ë) Fushat e njohurive, për të cilat do të intervistohen kandidatët, dhe bibliografitë përkatëse.

8. Kandidati për Drejtorin e Përgjithshëm të INSTAT-it duhet të plotësojë kriteret e parashikuara në pikën 5, të nenit 16, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikën zyrtare”.

9. KPVK-ja bën vlerësimin e kandidaturave të paraqitura brenda 35 (tridhjetë e pesë) ditëve kalendarike, nga data e mbylljes së aplikimeve. Nëse numri i aplikimeve të paraqitura është i lartë, atëherë vlerësimi i tyre nga komisioni mund të zgjatet, por jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike.

10. Procedura e vlerësimit të aplikantëve kryhet në dy faza. Në fazën e parë, KPVK-ja bën vlerësimin e dosjeve të tyre, për të verifikuar nëse ata plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 5, të nenit 16, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikën zyrtare”. Në përfundim të procesit të verifikimit KPVK-ja harton listën me emrat e aplikantëve që plotësojnë kriteret dhe listën me emrat e aplikantëve që nuk plotësojnë kriteret për t’u emëruar.

Aplikantët, që plotësojnë kriteret, njoftohen individualisht për kualifikimin e tyre, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga vendimi i KPVK-së. Lista e kandidatëve të kualifikuar publikohet në faqen elektronike zyrtare të Kryeministrisë.

Aplikantët, që nuk plotësojnë kriteret, njoftohen individualisht për skualifikimin dhe arsyet e skualifikimit, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga vendimi i KPVK-së.

Në rast se janë më pak se 3 (tre) aplikantë, që përmbushin kriteret ligjore, procedura rishpallet nga e para.

11. Personat e skualifikuar, sipas pikës 10, të këtij vendimi, mund të paraqesin ankesë pranë KPVK-së brenda 5 (pesë) ditëve, nga marrja e njoftimit të skualifikimit. Ankesat shqyrtohen nga KPVK-ja brenda 3 (tri) ditëve, nga depozitimi i tyre. Dokumentacioni i shqyrtimit të ankesave dhe mënyrës së trajtimit të tyre është pjesë e dokumentacionit të testimit, që i dorëzohet, fillimisht, Këshillit të Ministrave, për përzgjedhjen e kandidaturave, dhe më pas Kuvendit, për caktimin e kandidatit fitues.

12. Në fazën e dytë, KPVK-ja kryen vlerësimin e kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë. Vlerësimi maksimal është 100 pikë. Vlerësimi i kandidatëve bëhet sipas një procedure që përfshin pikët maksimale për secilën nga fazat e mëposhtme:

a) Vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, që përfshin vlerësimin e arsimimit, të përvojës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, deri në 40 pikë, sipas pikës 14, të këtij vendimi;

b) Intervistën e strukturuar me gojë, deri në 60 pikë.

13. Çdo anëtar i KPVK-së jep vlerësimin e tij individual për secilin kandidat. Vlerësimi përfundimtar për kandidatin llogaritet si mesatare e pikëve të vendosura nga secili prej anëtarëve.

14. Vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve për pozicionin “Drejtore i Përgjithshëm i INSTAT –it” do të kryhet në bazë të:

a) Vlerësimit të certifikatave apo kualifikimeve të tjera, veç gradës shkencore “Doktor”: deri në 10 pikë;

b) Përvojës në punë në pozicione drejtuese: deri në 10 pikë;

c) Përvojës në fushën e prodhimit dhe/ose përdorimit të statistikave: deri në 10 pikë;

ç) Zotërimit të gjuhëve të huaja, veç asaj angleze: deri në 5 pikë;

d) Prezantimeve të punimeve në konferenca/simpoziume shkencore: deri në 5 pikë.

15. Intervista e strukturuar me gojë kryhet për të vlerësuar kandidatët për njohuritë që zotërojnë në



fushën e statistikave, filozofinë drejtuese të tyre, strategjitë dhe risitë që mund të sjellin si drejtues të një institucioni publik.

16. Intervista e strukturuar me gojë kryhet, si më poshtë vijon:

a) Intervista zhvillohet në ditën dhe në vendin e caktuar në shpalljen e konkursit;

b) Komisioni përcakton temat e intervistës dhe pikët përkatëse, maksimale, në këto fusha:

i. njohuri në fushën e statistikave, përmbajtjen e programit pesëvjeçar të statistikave zyrtare;

ii. njohuri për Kushtetutën, Kodin e Procedurave Administrative dhe për legjislacionin e funksionimin e administratës publike;

iii. njohuri për legjislacionin mbi të cilin mbështetet funksionimi i Sistemit Kombëtar Statistikor;

iv. filozofia drejtuese;

v. strategjitë dhe risitë që mund të sjellë gjatë kryerjes së funksionit drejtues.

c) Lidhur me përcaktimet e nënndarjeve “iv” e “v”, të shkronjës “b”, të kësaj pike, kandidatët i paraqesin komisionit një prezantim të shkurtër në format *Power Point*.

17. Në përfundim të procesit të vlerësimit KPVK-ja përgatit listën me emrat e kandidatëve, shumën e pikëve të secilit, dhe i njofton individualisht, brenda 2 (dy) ditëve nga kryerja e vlerësimit, për rezultatin përkatës. Lista e kandidatëve dhe pikët e secilit publikohen në faqen elektronike zyrtare të Kryeministrit.

18. Personat e interesuar mund të paraqesin ankesat në KPVK brenda 5 (pesë) ditëve, nga njoftimi i vlerësimit. Ankesat shqyrtohen nga KPVK-ja brenda 3 (tri) ditëve nga depozitimi i tyre.

19. Dokumentacioni i shqyrtimit të ankesave, sipas pikës 18, të këtij vendimi, dhe mënyrës së zgjidhjes së tyre është pjesë e dokumentacionit të testimit, që i dorëzohet Këshillit të Ministrave për përzgjedhjen e kandidaturave dhe, më pas, Kuvendit, për caktimin e kandidatit fitues.

20. Në fund të vlerësimit të kandidatëve KPVK-ja harton procesverbalin përmbledhës, ku pasqyrohet i gjithë informacioni për procedurën e ndjekur dhe vlerësimin e kandidatëve.

21. Në përfundim, KPVK-ja rendit kandidatët në bazë të pikëve të marra dhe ia dërgon listën Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave për vendimmarrje të mëtejshme nga Këshilli i Ministrave.

22. Këshilli i Ministrave, pas shqyrtimit të listës së kandidatëve të kualifikuar, i propozon Kuvendit jo më pak se 3 (tri) kandidatura, të cilat plotësojnë kërkesat e mësipërme dhe krijojnë bindjen e Këshillit të Ministrave për aftësinë e tyre profesionale në fushën e prodhimit statistikor e të drejtimit të një institucioni.

23. Propozimi i kandidaturave Kuvendit shoqërohet me dokumentacionin e plotë administrativ të përzgjedhjes së kandidatëve dhe me procesverbalin e nënshkruar nga KPVK-ja, sipas pikës 17, të këtij vendimi.

24. Në rast se asnjë nga kandidaturat e propozuara nuk miratohen nga Kuvendi, procedura për përzgjedhjen e kandidaturave fillon nga e para, sipas rregullave të këtij vendimi.

25. KPVK-ja e ushtron veprimtarinë e saj në ambientet e Kryeministrit ose të ASPA-s deri në emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT-it nga Kuvendi.

26. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave dhe anëtarët e Komisionit të Posaçëm të Vlerësimit të Kandidaturave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 670, datë 7.11.2018

PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES, TË PËRFAQËSIMIT, EMËRIMIT E SHKARKIMIT, RREGULLAT E FUNKSIONIMIT DHE MASËN E SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË STATISTIKAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 10, të nenit 22, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikën zyrtare”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, të funksionimit dhe masës së shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave, me qëllim funksionimin korrekt të



këtij këshilli, për garantimin e profesionalizmit, të pavarësisë dhe integritetit të lartë moral, nëpërmjet kryerjes së procedurave transparente përzgjedhëse, duke u mbështetur në kritere profesionale, për të përmbushur detyrat e përcaktuara në ligjin për statistikat zyrtare.

2. Anëtarët e Këshillit të Statistikave, sipas shkronjave “a”, “ç”, “d”, “dh” e “ë”, të pikës 2, të nenit 22, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikat zyrtare”, propozohen nga Këshilli i Ministrave. Procedurat përzgjedhëse të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Statistikave, për këtë rast, kryhen nën përgjegjësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, nëpërmjet zbatimit të procedurave të hapura, të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 e 2.4, të këtij vendimi.

2.1 Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për anëtarë të Këshillit të Statistikave, që propozohen nga Këshilli i Ministrave, janë, si më poshtë vijon:

a) Kandidati për anëtar, përfaqësues i organeve të vetëqeverisjes vendore:

i. të jetë nga radhët e nëpunësve të këtyre organeve;

ii. të ketë për natyrë pune përdorimin e statistikave;

iii. të ketë punuar në fushën e përdorimit të statistikave, për shkak të detyrës, për jo më pak se 3 (tre) vjet.

b) Kandidatët për anëtarë, përfaqësues të përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare:

i. të jenë nga radhët e nëpunësve civilë të Kryeministrit, të cilët merren, kryesisht, me hartimin e strategjive zhvillimore dhe monitorimin e zbatimit të tyre;

ii. të jenë nëpunës civilë, të paktën, të nivelit të mesëm drejtues;

iii. të kenë lidhje me përdorimin e të dhënave statistikore në natyrën e punës së tyre;

iv. të kenë jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë pune në përdorimin e statistikave.

c) Kandidatët për anëtarë, përfaqësues të botës akademike:

i. Të jenë nga radhët e personelit akademik, të punësuar me kohë të plotë, të institucioneve të arsimit të lartë, publik ose privat, të licencuar e akredituar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;

ii. të kenë përvojë në punë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në fushën e statistikave ose të ekonomisë apo shkencave të natyrës;

iii. të zotërojnë tituj akademikë.

ç) Kandidati për anëtar, përfaqësues i shoqërisë civile:

i. Të jetë nga radhët e organizatave jofitimprurëse, që përdorin tregues statistikorë për kryerjen e veprimtarisë së tyre;

ii. të jetë i punësuar në organizatë për jo më pak se 3 (tre) vjet;

iii. të jetë i angazhuar në përdorimin e statistikave në fushat e ekonomisë, të shkencave të natyrës apo shkencave sociale.

d) Kandidati për anëtar, përfaqësues i medias:

i. të jetë nga radhët e medias kombëtare;

ii. të jetë i punësuar me kohë të plotë;

iii. të ketë përvojë në punë jo më pak se 10 (dhjetë) vite në fushën e gazetarisë ekonomike.

2.2 Për kryerjen e procedurës së përzgjedhjes, sipas kriterëve të përcaktuara në nënpikat e pikës 2, të këtij vendimi, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave ngre një komision *ad-hoc*, i cili përbëhet nga dy përfaqësues të Kryeministrit dhe një përfaqësues të INSTAT-it, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT-it.

2.3 Shpallja për vendin e lirë për anëtar të Këshillit të Statistikave publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, në faqet zyrtare elektronike të Kryeministrit dhe INSTAT-it, deri në përfundimin e afatit të aplikimit, dhe përmban:

a) Listën e kriterëve të pranimit;

b) Listën e dokumenteve, që duhet të paraqiten;

c) Vendin ku duhet të paraqiten dhe afatin deri kur do të paraqiten dokumentet;

ç) mënyrën e njoftimit e të komunikimit me palët.

2.4 Komisioni *ad-hoc* bën vlerësimin e dosjeve të kandidatëve, për të verifikuar nëse ata plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë vendim, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, nga data e mbylljes së aplikimeve. Në përfundim të procesit të verifikimit, komisioni harton listën me emrat e aplikantëve që plotësojnë kriteret për anëtar të Këshillit të Statistikave dhe ia paraqet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave për propozim në Këshillin e Ministrave.

3. Anëtarët e Këshillit të Statistikave, sipas shkronjave “b”, “c” dhe “e”, të pikës 2, të nenit 22, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikat zyrtare”,



propozohen nga titullarët e institucioneve përkatëse.

3.1 Kandidatura e propozuar nga Banka e Shqipërisë duhet të përmbushë kriteret, si më poshtë vijon:

a) Të jetë nëpunës i nivelit drejtues të një departamenti;

b) Të gëzojë reputacion të lartë profesional;

c) Të ketë njohuri për metodat statistikore;

ç) Të ketë jo më pak se 5 (pesë) vjet përvojë pune në institucionet financiare.

3.2 Kandidatura e propozuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë duhet të përmbushë kriteret, si më poshtë vijon:

a) Të jetë nëpunës civil, të paktën, i nivelit të mesëm drejtues;

b) Të ketë njohuri në metodat statistikore;

c) Të ketë jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë pune në përdorimin e statistikave.

3.3 Kandidatura e propozuar nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë duhet të përmbushë kriteret, si më poshtë vijon:

a) Të jetë nga radhët e këtij institucioni ose nga radhët e anëtarëve të tij;

b) Të ketë përvojë të spikatur në fushën ekonomike;

c) Të ketë përvojë të mëparshme në fushën e përdorimit të statistikave.

4. Institucionet që propozojnë anëtarët e Këshillit të Statistikave, sipas pikave 3 dhe 4, të nenit 22, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikën zyrtare”, jo më vonë se 1 muaj, para mbarimit të mandatit të anëtarit, duhet të dërgojnë, zyrtarisht, pranë Kuvendit, propozimin për kandidaturën për pozicionin e anëtarit në Këshillin e Statistikave. Propozimi për kandidaturën përfaqësuese shoqërohet me një relacion shpjegues dhe dokumentacionin shoqërues për plotësimin e kriterëve të përcaktuara në këtë vendim.

5. Në rastet e vendeve vakante për anëtarë në Këshillin e Statistikave, INSTAT-i njofton, menjëherë, institucionet propozuese për fillimin e procedurave të plotësimit të vendeve vakante.

6. Anëtarët e Këshillit të Statistikave shkarkohen nga Kuvendi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 22, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikën zyrtare”. Propozimi i shkarkimit të tyre kryhet nga institucioni që ka të drejtën e propozimit të emërimit, sipas përkatësisë.

7. Këshilli i Statistikave mbledhet, të paktën, 3 (tri) herë në një vit kalendarik. Mbledhja thirret nga kryetari i Këshillit të Statistikave. Në mungesë të tij, mbledhja thirret nga zëvendëskryetari dhe, në mungesë të këtij të fundit, nga anëtar i më i vjetër në detyrë.

8. Kryetari vendos për datën, kohën e mbledhjes së radhës, dhe njofton anëtarët e këshillit, të paktën, 5 (pesë) ditë para mbledhjes. Rendi i ditës u njoftohet anëtarëve jo më vonë se 2 (dy) ditë, para organizimit të mbledhjes. Çdo ndryshim për datën dhe kohën e vendosur për mbledhje u njoftohet anëtarëve të Këshillit të Statistikave jo më vonë se 2 (dy) ditë para mbledhjes.

9. Kryetari është i detyruar të thërrasë mbledhjen kur atë e kërkon, me shkrim, të paktën 1/3 e anëtarëve të Këshillit të Statistikave ose Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it. Në këto raste, mbledhja organizohet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas kërkesës së paraqitur prej tyre.

10. Mbledhja është e vlefshme kur në të janë të pranishëm, të paktën, 7 (shtatë) anëtarë të këshillit. Mbledhja mbahet në përputhje me rendin e ditës. Diskutimet dhe vendimet për çdo pikë të rendit të ditës mbahen në procesverbal, nga sekretariati i Këshillit të Statistikave.

11. Vendimet e Këshillit të Statistikave janë të vlefshme kur miratohen nga, të paktën, 7 (shtatë) anëtarë të këtij këshilli. Ato zbardhen brenda 3 (tre) ditëve, nga data e mbledhjes.

12. Këshilli i Statistikave thërret mbledhjen e parë brenda 1 (një) muaji, nga konstituimi i mandateve të anëtarëve të tij.

13. Sekretariati i Këshillit të Statistikave sigurohet nga INSTAT-i. Sekretariati organizon mbledhjet, mban dokumentacionin përkatës, procesverbalin, e nënshkruan atë, pasi ua ka kaluar të gjithë anëtarëve për të konfirmuar saktësinë e tij, dhe zbardh të gjitha vendimet e Këshillit të Statistikave.

14. Anëtarët e Këshillit të Statistikave, gjatë ushtrimit të detyrës, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, informacionin që sigurohet prej tyre dhe të mos i përdorin ato për interesa personale.

15. Masa e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave është sipas përcaktimit të bërë në vendimin nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të



Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore”.

16. Vendimi nr. 999, datë 25.10.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurat e përfaqësimit, të përzgjedhjes, të emërimit e të shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të këshillit të statistikave”, shfuqizohet.

17. Dispozitë kalimtare

Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, që, brenda 5 (pesë) ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të fillojë procedurat për plotësimin e vendeve vakante në Këshillin e Statistikave, sipas këtij vendimi, për:

a) 1 anëtar, përfaqësues nga organet e vetëqeverisjes vendore;

b) 1 anëtar, përfaqësues nga bota akademike;

c) 1 anëtar, përfaqësues të medias.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 671, datë 7.11.2018

PËR NGRITJEN, FUNKSIONIMIN DHE DETYRAT E KOMISIONIT KOMBËTAR PËR NOMENKLATURËN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 24, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikën zyrtare”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën për kryerjen e përditësimit, përshtatjen dhe zbatimin e klasifikimeve zyrtare ekonomike e sociale, në përputhje me nomenklaturat evropiane dhe ndërkombëtare.

2. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën kryesohet nga drejtori i përgjithshëm i INSTAT-it dhe në përbërje ka përfaqësues nga:

- a) Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme 1;
- b) Ministria e Brendshme 1;
- c) Ministria e Financave dhe Ekonomisë 1;

- ç) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë 1;
- d) Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë 1;
- dh) Ministria e Drejtësisë 1;
- e) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 1;
- ë) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 1;
- f) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit 1;
- g) Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes 1;
- gj) Banka e Shqipërisë 1;
- h) Shërbimi Kombëtar i Punësimit 1;
- i) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave 1;
- j) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve 1;
- k) Instituti i Sigurimeve Shoqërore 1;
- l) Qendra Kombëtare e Biznesit 1;
- ll) INSTAT-i 2.

3. Përfaqësuesit e institucioneve, anëtarë të Komisionit, caktohen nga titullarët e institucioneve, sipas kriterëve e kërkesave të paraqitura nga Instituti i Statistikave, dhe brenda 10 (dhjetë) ditëve njoftojnë INSTAT-in.

4. Për përgatitjen e mbledhjeve dhe koordinimin e çështjeve të Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën krijohet sekretariati i Komisionit, i cili përbëhet nga specialistë të Institutit të Statistikave. Rregullat për funksionimin e sekretariatit përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën.

5. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën mbledhet me thirrjen e kryetarit. Mbledhjet e Komisionit zhvillohen sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 8480, datë 25.8.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

6. Masa e shpërblimit të anëtarëve të Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën, për çdo mbledhje, është sipas përcaktimit të bërë në vendimin nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore”.

7. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën mund të ngrëjë grupe pune, sipas fushave dhe nevojave të tij, me përbërje nga të gjitha institucionet e përfshira në Komision ose një pjesë të tyre. Rregullat për funksionimin e këtyre grupeve dhe për shkallën e tyre të përgjegjësisë



përcaktohen me vendim të veçantë të këtij Komisioni.

8. Nomenklaturat e miratuara paraprakisht nga Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën miratohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

9. Vendimi nr. 426, datë 15.5.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën”, të ndryshuar, shfuqizohet.

10. Ngarkohen Instituti i Statistikave dhe institucionet e përmendura në pikën 2, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 672, datë 7.11.2018

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT
TË MIRËKUPTIMIT, NDËRMJET
QEVERISË SË MBRETËRISË SË
SUEDISË DHE SHTABIT TË KOMANDËS
SUPREME ALEATE PËR
TRANSFORMIMIN, SI DHE SHTABIT
SUPREM TË FUQIVE ALEATE NË
EVROPË, NË LIDHJE ME DHËNIEN E
MBËSHTETJES SË SHTETIT PRITËS
PËR EKZEKUTIMIN E
OPERACIONEVE/STËRVITJEVE DHE
AKTIVITETEVE USHTARAKE TË
NGJASHME TË NATO-S DHE NOTËS SË
PRANIMIT PËR T’U BËRË
PJESË E TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet qeverisë së Mbretërisë së Suedisë dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, si dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë, në lidhje me dhënie e mbështetjes së shtetit pritës për ekzekutimin e operacioneve/stërvitjeve dhe aktiviteteve ushtarake të ngjashme të NATO-s dhe notës së pranimit për

t’u bërë pjesë e tij, sipas tekstit të memorandumit dhe notës bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

NATO E PAKLASIFIKUAR BASHKËLIDHUR 02 TO
SH/RESJ4LOG/EM/17-31800

Datë 10 gusht ‘17

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI (MOU)
NDËRMJET QEVERISË SË MBRETËRISË
SË SUEDISË DHE SHTABIT TË
KOMANDËS SUPREME ALEATE PËR
TRANSFORMIMIN, SI DHE SHTABIT
SUPREM TË FUQIVE ALEATE NË
EVROPË, NË LIDHJE ME DHËNIEN E
MBËSHTETJES SË SHTETIT PRITËS PËR
KRYERJEN E
OPERACIONEVE/STËRVITJEVE DHE
AKTIVITETEVE USHTARAKE TË
NGJASHME TË NATO-s**

**NATO E PAKLASIFIKUAR
LISTA E PËRMBAJTJES**

SEKSIONI I PARË	PËRKUFIZIME
SEKSIONI I DYTË	QËLLIMI
SEKSIONI I TRETË	OBJEKTI
SEKSIONI I KATËRT	DOKUMENTET E REFERUARA
SEKSIONI I PESTË	PËRGJEGJËSITË
SEKSIONI I GJASHTË	DISPOZITA FINANCIARE
SEKSIONI I SHTATË	KONSIDERATA JURIDIKE
SEKSIONI I TETË	MBROJTJA E FORCËS
SEKSIONI NËNTË	SIGURIA DHE DEKLARIMI I INFORMACIONIT
SEKSIONI I DHJETË	HYRJA NË FUQI, KOHËZGJATJA DHE PRISHJA/ PËRFUNDIMI
SEKSIONI I NJËMBËDHJETË	NDRYSHIMI DHE INTERPRETIMI
NËNSHKRIMI	
ANEKSI	



NATO E PAKLASIFIKUAR

HYRJJE

Qeveria e Mbretërisë së Suedisë dhe Shtabi i Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT) dhe Shtabi Suprem i Fuqive Aleatëve në Evropë (SHAPE), në vijim të referuara si “Pjesëmarrësit”:

Duke pasur parasysh dispozitat e Traktatit të Atlantikut të Veriut, të datës 4 prill 1949 dhe, veçanërisht, nenin 3 të saj;

Duke pasur parasysh Dokumentin Kuadër të Partneritetit për Paqe të nxjerrë nga krerët e shteteve dhe qeverive që merrnin pjesë në mbledhjen e Këshillit Atlantik të Veriut (Dokumenti Kuadër), i datës 10 janar 1994;

Duke pasur parasysh dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Palëve në Traktatin Atlantik të Veriut në lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (NATO-SOFA), të datës 19 qershor 1951, Protokollin mbi Statusin e Komandave Ushtarake Ndërkombëtare të ngritura në pajtim me Traktatin Atlantik të Veriut (Protokolli i Parisit), të datës 28 gusht 1952, Marrëveshjen ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin Atlantik të Veriut dhe shteteve të tjera që marrin pjesë në partneritetin për paqe, në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (PfP SOFA), të datës 19 qershor 1995, Protokollin Shtesë të Marrëveshjes ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin Atlantik të Veriut dhe shteteve të tjera që marrin pjesë në partneritetin për paqe, në lidhje me statusin e forcave të tyre (Protokolli Shtesë i PfP SOFA), të datës 19 qershor 1995, Protokollin tjetër Shtesë të Marrëveshjes ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin Atlantik të Veriut dhe shteteve të tjera që marrin pjesë në partneritetin për paqe, në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (Protokolli tjetër Shtesë i PfP SOFA), datë 19 dhjetor 1997, duke përfshirë rezervat e bëra nga secila prej atyre Palëve në ato marrëveshje;

Duke pasur parasysh dispozitat e Marrëveshjes së Sigurisë ndërmjet qeverisë së Suedisë dhe Organizatës së Traktatit Atlantik të Veriut, të datës 6 shtator 1994 dhe Masës Administrative për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar të NATO-s të dhënë Suedisë, të datës 14 qershor 2012;

Duke pasur parasysh konceptin e angazhimit të forcave të NATO-s dhe forcave të koalicionit nën komandën e NATO-s dhe kontrollit të ose

nëpërmjet territorit të Mbretërisë së Suedisë gjatë periudhave të paqes, krizës, emergjencës dhe konfliktit në mbështetje të aktiviteteve ushtarake të NATO-s;

Duke pasur parasysh konceptin e stërvitjeve dhe të operacioneve që parashikohen të ndodhin me NATO-n, Partneritetin për Paqe (PfP) dhe forcave të tjera të udhëhequra nga NATO;

Dhe duke marrë parasysh nevojat e qeverisë së Mbretërisë së Suedisë dhe nevojat e Operacioneve të Komandës Aleate (ACO) dhe Komandës Aleate për Transformimin (ACT), që më poshtë quhen “Komanda Strategjike” (SC);

Pjesëmarrësit kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm:

SEKSIONI I PARË

1. PËRKUFIZIME

Për qëllimet e këtij MOU-je dhe dokumenteve pasuese, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1.1 “Forcat”, të gjithë komponentët e forcës së udhëhequr nga NATO, që përfshin të gjithë personelin, kafshët, materialet dhe rezervat, së bashku me çdo komponent tjetër civil të këtyre forcave, siç përkufizohen te NATO-SOFA, Protokolli i Parisit dhe PfP ose shtetet e tjera që marrin pjesë nën udhëheqjen e NATO-s. Termi përfshin, gjithashtu, të gjitha anijet, avionët, automjetet, magazinat, pajisjet dhe municionet, si dhe burimet e lëvizjes në ajër, tokë dhe det, së bashku me shërbimet e tyre mbështetëse, duke përfshirë kontraktuesit që angazhojnë ose mbështesin forcën.

Kontraktues (NATO) bizneset, individët dhe subjektet josuedeze që nuk janë rezidentë në territorin e Suedisë, që angazhohen nga NATO, shtetet anëtare të NATO-s, dhe shtetet jopjesëtare të NATO-s që kontribuojnë për operacionet e drejtuar nga NATO dhe që ofrojnë mallra dhe/ose shërbime të çdo natyre në territorin e Suedisë për NATO-n brenda kuadrit të operacioneve, stërvitjeve, eksperimenteve ose aktivitete të tjera ushtarake të ngjashme të drejtuara nga NATO-ja. Kjo përfshin kontraktuesit, të punësuarit, si dhe nënkontraktuesit dhe të punësuarit e tyre që veprojnë në kuadrin e operacionit, por kjo nuk përfshin kontraktuesit lokalë, të punësuarit e tyre, nënkontraktuesit dhe të punësuarit e tyre.

1.2 “Aktivitete ushtarake të NATO-s”, veprimet ushtarake, duke përfshirë stërvitjen, trajnimin, eksperimentimin operacional dhe



aktivitete të ngjashme ose kryerja e misioneve ushtarake strategjike, taktike, të shërbimit, trajnuese ose administrative të realizuara nga forcat; procesi i zhvillimit të luftimit, duke përfshirë sulmin, lëvizjen, furnizimin dhe manovrat që nevojiten për të arritur objektivat e çdo lufte ose fushate;

1.3 “Komandant i NATO-s”, një komandant ushtarak në zinxhirin e komandës së NATO-s.

1.4 “Organizatat e NATO-s”, komandat ose njësitë e organizuara të forcave nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.5 “Komanda Ushtarake Ndërkombëtare”, Komanda Ushtarake Ndërkombëtare në strukturat e integruara të komandës së NATO-s ose që u është dhënë ky status nga NAC/DPC. Kjo përfshin aktivitetet që mund të jenë detaje të përkohshme ose njësi të komandave.

1.6 “Komanda Kombëtare”, komandat e forcave kombëtare në komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.7 “Komanda Shumëkombëshe”, komanda me personel nga më shumë se një shtet që formohen me marrëveshjen e shteteve pjesëmarrëse dhe nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.8 “Shtetet Dërguese (SD)”, ato shtete dhe Komanda Ushtarake Ndërkombëtare ose elementët e tyre që angazhohen në territorin e SP-së në mbështetje të Operacioneve të NATO-s.

1.9 “Shteti Pritës (SP)”, Mbretëria e Suedisë.

1.10 “Komandat ose Komandantët Strategjikë (KK)”, Komandanti Suprem i Aleatëve në Evropë (SACEUR), Komandanti i Operacioneve të Komandës Aleate (ACO) dhe Komandanti Suprem i Aleatëve për Transformimin (SACT), Komandanti të Komandës Aleate për Transformimin (ACT).

1.11 “Mbështetje e Shtetit Pritës (MSP)”, Asistenca civile dhe ushtarake që u jepet në paqe, emergjencë, krizë dhe konflikt nga një Shtet Pritës, forcave dhe organizatave aleate që ndodhen, operojnë ose kalojnë tranzit përmes territorit, ujërave territoriale ose hapësirës ajrore të Shtetit Pritës.

1.12 “Mbrotjtja e Forcës (MF)”, të gjitha masat e marra dhe mjetet që përdoren për të minimizuar vulnerabilitetin e personelit, mjedisëve, pajisjeve dhe operacioneve ndaj çdo rreziku në të gjitha situatat, për të ruajtur lirinë e veprimit dhe efektivitetin operacional të forcës.

1.13 “Shpenzimet”, ato shpenzime që shoqërohen me ngritjen, mbështetjen dhe mbajtjen e komandave, forcave dhe formacioneve kombëtare, shumëkombëshe ose të NATO-s. Për qëllimet e këtij MOU-je dhe dokumenteve të saj pasuese:

a) “Shpenzimet e zakonshme të NATO-s”, ato shpenzime për të cilat bihet dakord të jenë përgjegjësi e përbashkët e Aleancës

b) “Shpenzime të përbashkëta”, ato shpenzime për të cilat bihet dakord paraprakisht të jenë përgjegjësi e përbashkët e më shumë se një shteti. Masat e shpenzimeve të përbashkëta bazohen zakonisht në një formulë të detajuar në Marrëveshjet Teknike përkatëse dhe/ose Masat e Përbashkëta të Zbatimit.

c) “Shpenzime të drejtpërdrejta kombëtare”, ato shpenzime që konsiderohen të jenë një përgjegjësi e një SN-je të vetme.

1.14 “Financim i Përbashkët i NATO-s”, fondet e dhëna nga shtetet e NATO-s dhe që ofrohen me miratimin nëpërmjet buxheteve të NATO-s për shpenzimet e zakonshme që shkaktohen gjatë zhvillimit të aktiviteteve ushtarake të NATO-s të përcaktuara në to.

1.15 “Notë Pranimi (NOA)”, një dokument që tregon synimin e një SN-je për të marrë pjesë në masat për HNS-në, sipas dispozitave të këtij MOU-je për një aktivitet ushtarak të specifikuar të NATO-s.

1.16 “Deklaratë Synimi (SOI)”, një dokument që tregon një synim të një SN-je për të marrë pjesë në masat për HNS-në sipas dispozitave të këtij MOU-je, por duke iu nënshtruar rezervave të caktuara specifike. HN-ja konfirmon nëse rezervat janë të pranueshme për mbështetje të HNS-së.

1.17 “Masë Teknike (TA)”, një masë pasuese dypalëshe për një aktivitet ushtarak të specifikuar të NATO-s. Ajo detajon përgjegjësitë dhe procedurat për dhënien e HNS-së nga HN-ja ndaj Komandantit të NATO-së dhe SN-ve.

1.18 “Masë e Përbashkët Zbatimi (JIA)”, një masë pasuese dypalëshe që vendos angazhimin ndërmjet nënshkruesve, në lidhje me dhënien dhe marrjen e HNS-së. Kjo përfshin informacionin e hollësishëm për mbështetjen e kërkuar dhe të ofruar, procedurat e specifikuar të vendit për zbatimin dhe rimbursimin ose termat e pagesës.

1.19 “Komiteti Drejtues i Mbështetjes së Përbashkët i Shtetit Pritës (JHNSSC)”, një komitet



i ngritur në mënyrë të posaçme dhe i bashkëkryesuar nga HN-ja dhe Komandanti i NATO-s. Komiteti, i përbërë nga përfaqësuesit e autorizuar nga të gjithë SN-të, HN-ja dhe Komandanti/ët e NATO-s takohen për të zhvilluar masat e nevojshme përmirësuese, në lidhje me HNS-në, si TA-ja dhe JIA-të, sipas rastit.

1.20 “Vendet operacionale”, vendet që gjenden në territorin e HN-së për qëllimin e mbështetjes operacionale dhe/ose logjistike për forcën për aktivitetet ushtarake të NATO-s. Këto vende janë detashmente të një Komande Strategjike nën komandën dhe kontrollin e një Komandanti të NATO-s.

1.21 Pjesëmarrësit janë në dijeni, që përveç kur një kuptim specifikohet ndryshe në këtë MOU për NATO-n, zbatohet fjalori i NATO-s për termat dhe përkufizimet (AAP-6).

SEKSIONI I DYTË

QËLLIMI

2.1 Qëllimi i këtij MOU-je është vendosja e politikës dhe e procedurave për përcaktimin e vendeve operacionale dhe ofrimin e HNS-së të forcat e NATO-s ose të mbështetur nga HN-ja, gjatë aktivitetëve ushtarake të NATO-s.

2.2 Ky MOU dhe dokumentet e tij pasuese synohet të shërbejnë si bazë për planifikimin nga autoriteti përkatës i HN-së dhe nga komandantët e NATO-s, duke parashikuar masat e HNS-së për një sërë aktivitetesh ushtarake të NATO-s. Këto misione përfshijnë ato për të cilat janë identifikuar forcat e angazhuara dhe ato për të cilat duhet të identifikohen forcat.

SEKSIONI I TRETË

OBJEKTI DHE MASA TË PËRGJITHSHME

3.1 Dispozitat e NATO-SOFA ose /PfP SOFA, Protokollit të Parisit dhe Protokollit tjetër Shtesë dhe çdo marrëveshjeje tjetër përkatëse që mund të jenë në fuqi ndërmjet Komandave Supreme dhe HN-së zbatohen për të gjitha aktivitetet ushtarake të NATO-s.

3.2 HN-ja njeh vendet operacionale të vendosura në zbatim të këtij MOU-je të jenë detashmente të Komandave Supreme krijuese dhe aktivitetet e këtyre detashmentëve të jenë ndërmarje të Komandave Supreme. Këto vende që duhet të vendosen identifikohen në dokumente pasuese. Masat e komandës dhe të kontrollit do të caktohen në planet përkatëse operacionale.

3.3 Ky MOU synon të jetë në pajtim me doktrinën dhe politikën e NATO-s dhe ofron një masë dhe strukturë ombrellë për HNS-në.

3.4 HN-ja do të japë mbështetje brenda kapacitetit të tij të plotë, duke iu nënshtruar disponibilitetit dhe brenda kufizimeve praktike të rrethanave që ekzistojnë për momentin, për forcat e angazhuara në aktivitetet ushtarake të NATO-s. Hollësitë e kësaj mbështetjeje do të trajtohen në dokumente shtesë.

3.5 Dispozitat e këtij MOU-je zbatohen në paqe, emergjencë, krizë dhe konflikte ose periudha të tensionit ndërkombëtar, siç mund të përcaktohet bashkërisht nga autoritetet përkatëse të HN-së dhe NATO-s.

3.6 Ndërsa SN-të inkurajohen të marrin pjesë në aktivitetet ushtarake të NATO-s dhe të pranojnë dispozitat e këtij MOU-je, si një dokument ombrellë, sipas të cilit HNS-ja jepet nga HN-ja, marrëveshjet e veçanta dypalëshe me shtetet individuale mund të merren parasysh nga HN-ja rast pas rasti.

3.7 HN-ja dhe SC-të mund të caktojnë përfaqësues për të negociuar dokumentet që mbështesin dhe përforcojnë këtë MOU.

3.8 Aktivitetet ushtarake të NATO-s të mbështetura nga ky MOU mund të kërkojnë operacione ajrore të mbështetjes shumëkombëshe me avionë dhe helikopterë dhe, në rastin e porteve, me anije mbështetëse ushtarake dhe mallrash. HN-ja pranon që lëvizja e këtyre avionëve, helikopterëve, anijeve dhe ekuipazhit të tyre në dhe përmes hapësirave territoriale të HN-së do të bëhet në bazë të një leje të përgjithshme për kohëzgjatjen e aktivitetit ushtarak të NATO-s. HN-ja do të administrojë/do të kontrollojë të gjitha aspektet e një lejeje të tillë.

SEKSIONI I KATËRT

DOKUMENTET E REFERENCËS

Dokumentet e referencës që mund të jenë të zbatueshme për këtë MOU gjenden tek aneksi A.

SEKSIONI I PESTË

PËRGJEGJËSITË

Brenda dispozitave të këtij MOU-je:

5.1 Shteti Pritës

a) Gjatë përgatitjes së dokumenteve mbështetëse dhe me ndodhjen e ndryshimeve dhe pas përfundimit të këtyre dokumenteve, HN-ja bën njoftim në kohën e duhur për Komandantin përkatës të NATO-s në lidhje me disponibilitetin



ose ndonjë mangësi të aftësive të HNS-së. HN-ja merr parasysh që planifikuesit e NATO-s mbështeten te dokumentet mbështetëse të përgatitura për këtë MOU dhe kërkojnë një njoftim në kohë për ndryshimet e planifikuara për strukturat dhe aftësitë kombëtare.

b) Me qëllim që të jepet mbështetje, HN-ja merr masat e nevojshme për burimet e mbështetjes për të përfshirë burimet civile dhe tregtare. Mbështetja e siguruar me prokurim tregtar përfitohet nëpërmjet një procesi ofertimi konkurrues nga ofertuesi më i ulët i përshtatshëm.

c) HN-ja mban regjistrat administrativë dhe financiarë të nevojshëm për të realizuar rimbursimin e HN-së për burimet e dhëna për forcat. Regjistrat që dokumentojnë transaksionet e financuara nga buxheti i NATO-s ofrohet për NATO-n, siç kërkohej nga qëllimet e auditimit.

d) Standardet e mallrave dhe të shërbimeve të dhëna nga HN-ja do të jenë në pajtim me hollësitë e përcaktuara te dokumentet mbështetëse.

e) HN-ja do të ruajë kontrollin mbi burimet e veta të HNS-së, përveç kur kontrolli i këtyre burimeve është lënë i lirë.

f) HN-ja do të ofrojë, para çdo aktiviteti ushtarak të NATO-s, një listë çmimesh për çdo mbështetje përkatëse ose të identifikuar të HN-së.

g) HN-ja do të ftojë SN-të të pranojë dispozitat e këtij MOU-je, nëpërmjet një note pranimi ose deklarimi synimi.

h) HN-ja (në bashkëpunim me Komandantin e NATO-s) i jep forcës mbështetje mjekësore dhe dentare nga personeli/pajisjet ushtarake të HN-së, sipas të njëjtave kushte që u jepet ushtarakëve të HN-ë.

i) HN-ja i ofron procedurat për lidhjet mjekësore ndërmjet HN-së dhe SN-së, duke përfshirë POC-in.

j) Gjatë zhvillimit të dokumenteve të mbështetjes, HN-ja do t'i ofrojë Komandantit të NATO-s kopje në gjuhën angleze të çdo rregulloreje shëndetësore, sigurie, mjedisore dhe bujqësore, që mund të zbatohet për aktivitetin ushtarak të NATO-s, si dhe çdo rregullore në lidhje me ruajtjen, lëvizjen ose asgjësimin e materialeve të rrezikshme.

k) HN-ja pranon që kopjet e listave të mallrave të SN-ve për pajisjet dhe furnizimet për përdorim ushtarak dhe personal, në pajtim me NATO-SOFA, do të jetë dokumentacioni i plotë për qëllimet doganore.

5.2 Komandanti i NATO-s

a) Komandanti i NATO-s garanton, në masën maksimale të mundshme, që dokumentet mbështetëse të specifikojnë tipin, sasinë dhe cilësinë e mbështetjes së kërkuar. Vihet re që struktura e misionit dhe e forcës që përcaktohet për një plan operacional (OPLAN), një urdhër operacional (OPORD) ose një urdhër operacional stërvitor (EXOPORD), nuk mund të specifikohet para kohe. Komandanti i NATO-s jep informacionin e nevojshëm shtesë për planifikimin e HN-së sa më shpejt të jetë e mundur.

b) Komandanti i NATO-s i bën HN-së njoftim në kohë në lidhje me çdo ndryshim të rrethanave dhe propozon ndryshimin e dokumenteve mbështetëse, sipas rastit.

c) Komandanti i NATO-s përcakton nëse ofrohet financimi i zakonshëm dhe cilat kërkesa janë të përshtatshme për financim të zakonshëm.

d) Komandanti i NATO-s përcakton dhe vendos prioritetet e kërkuara HNS dhe aprovon çmimet në lidhje me shpenzimet e zakonshme.

e) Komandanti i NATO-s garanton rimbursimin financiar për HN-në për HNS-të e rëna dakord, nëse paguhet nga financimi i zakonshëm. Në të gjitha rastet e tjera, Komandanti i NATO-s ndihmon në masën që është e nevojshme në përmbushjen e detyrimeve financiare ndërmjet HN-së dhe SN-ve.

f) Nëse kërkesat e SN-ve bien në konflikt me prioritetet e Komandantit të NATO-s për shpërndarjen e burimeve, Komandanti përkatës i NATO-s e zgjidh konfliktin me SN-të e përfshira.

g) Komandanti i NATO-s identifikon personelin dhe kërkesat e tjera për operacionin e vendeve që caktohen në HN.

h) Komandanti i NATO-s do të lehtësojë standardizimin e kërkesave dhe të kostos së mbështetjes gjatë negociatave dhe/ose të JHNSC-ja.

5.3 Shtetet dërguese

a) SN-të mund të zgjedhin të marrin pjesë në strukturën dhe procedurat për HNS-në, duke pranuar dispozitat e këtij MOU-je nëpërmjet një NOA-je ose duke nxjerrë një SOI për një aktivitet ushtarak të caktuar të NATO-s.

b) SN-të identifikojnë kërkesat e HNS-së ndaj HN-së dhe Komandantit përkatës të NATO-s.

c) Për kërkesat e kostos së drejtpërdrejtë kombëtare, SN-ja, normalisht, merr pjesë në



negociatat për HNS-të gjatë JHNSSC-së ose drejtpërdrejt me HN-në, nëse nuk krijohet një JHNSSC. SN-të ofrojnë pagesën e drejtpërdrejtë ose rimbursimin për HNS-të ndaj HN-së vetëm për shërbimet e dhëna nga burimet ushtarake, përveç kur përdoren, siç është rënë dakord, procedura të tjera pagese. Sipas masave kontraktuale të marra nga HN-ja dhe SN-të, mbështetja e dhënë nga burimet tregtare ose civile paguhen drejtpërdrejt nga SN-të.

d) SN-të ofrojnë personel të përshtatshëm të autorizuar për të marrë pjesë në diskutimet e HNS-së gjatë JHNSSC-së, nëse krijohet.

e) SN-të do të raportojnë ndryshimet e kërkesave HNS te HN-ja dhe Komandanti përkatës i NATO-s, kur ato kryhen dhe paraqet kërkesat e rishikuara të HNS-së dhe/ose situacionet.

f) SN-të janë përgjegjëse për shpenzimet e çdo shërbimi mjekësor ose dentar të dhënë nga HN-ja.

g) SN-të duhet të respektojnë rregulloret dhe procedurat për shëndetin, sigurinë, mjedisin dhe bujqësinë që janë identifikuar për vendet operacionale, si dhe çdo rregullore të HN-së për ruajtjen, lëvizjen ose asgjësimin e materialeve të rrezikshme.

SEKSIONI I GJASHTË

DISPOZITA FINANCIARE

6.1 Siç është parashikuar në NATO/PfP SOFA dhe/ose Protokollin e Parisit dhe/ose Protokollet e tjera Shtesë dhe/ose me marrëveshje reciproke dhe/ose konventa ndërkombëtare të zbatueshme në mënyrë të barabartë ndërmjet Pjesëmarrësve, aktivitetet e Komandave Ushtarake Ndërkombëtare, vendet operacionale, anijet, avionët ose automjetet në pronësi dhe/ose të kontraktuara nga NATO-ja dhe POL ofruar Forcave janë të përjashtuara nga tatimet, detyrimet, pagesat shtetërore, tarifatat dhe të gjitha pagesat e ngjashme.

6.2 Protokollin e Parisit dhe Protokollin tjetër Shtesë që zbatohen imunitetet dhe privilegjet në lidhje me Komandat Ushtarake Ndërkombëtare zbatohen për çdo element të komandave ose detashmente që mund të angazhohen te HN-ja në zbatim të një aktiviteti ushtarak të NATO-s.

6.3 Pajisjet, furnizimet, produktet dhe materialet që importohen përkohësisht dhe eksportohen nga territori i HN-së, në lidhje me një aktivitet ushtarak të NATO-s, janë të përjashtuara nga detyrimet,

tatimet dhe tarifatat e tjera. Procedurat e tjera doganore përcaktohen në pajtim me NATO-n ose PfP SOFA, Protokollin e Parisit dhe Protokollin tjetër Shtesë, sipas rastit.

6.4 Kuptohet që çdo përjashtim i referuar në seksionet 6.1 deri 6.3 nga detyrimet e TVSH-së dhe akcizës u jepet Shtabeve Ndërkombëtare Ushtarake dhe njërive të drejtuara nga NATO-ja si persona juridikë. Përjashtimet nga taksat për personat fizikë, që më sipër përkufizohen Forca, jepen në pajtim me dispozitat e përcaktuara në NATO/PfP SOFA dhe në Protokollin e Parisit/FAP, dhe marrëveshjet e tyre dypalëshe plotësuese që palët/ pjesëmarrësit mund të vendosin të lidhin.

6.5 Nëse përjashtimi i plotë nga tatimet, detyrimet, tarifatat ose pagesat e ngjashme nuk është e mundur për blerjet e kryera nga ekonomia e brendshme e HN-së, detyrimet nuk vendosen në një normë më të lartë se ajo që zbatohet për Forcat e Armatosura të HN-së. Të gjitha shpenzimet duhet të përpunohen me shumën më të vogël që shoqëron kërkesat administrative.

6.6 Transaksionet financiare që përfshijnë transferimin e fondeve dhe krijimin e llogarive në një institucion bankar privat ose qeveritar duhet të kryhen pa përftuar detyrime qeveritare ose tarifa qeveritare të asnjë lloji.

6.7 Masat përfundimtare financiare, veçanërisht ato në lidhje me Financimin e Zakonshëm të NATO-s, do të vendosen vetëm para zbatimit të një aktiviteti ushtarak të NATO-s. Të gjitha masat financiare që negocohen paraprakisht duhet të jenë specifike në lidhje me detyrimet financiare maksimale të NATO-s. Shpenzimet për të cilat nuk bihet specifikisht dakord që të jenë shpenzime të financuara nga NATO-ja, para se të realizohen shpenzimet, nuk marrin financim të zakonshëm nga NATO-ja.

6.8 Dokumentet mbështetëse ofrojnë bazën fillestare për vlerësimet e shpenzimeve dhe shërbejnë si bazë për kategorizimin e shpenzimeve si shpenzime të zakonshme të NATO-s (sipas rastit), shpenzime të përbashkëta ose shpenzime të drejtpërdrejta kombëtare.

6.9 Nëse Komandanti i NATO-s përcakton që disa shpenzime janë të përshtatshme dhe të ofrueshme nga financimi i zakonshëm i NATO-s (nga alokimet e aprovuara të buxhetit), SC-ja



përkatëse autorizon financimin e zakonshëm për ato shpenzime dhe i paguan drejtpërdrejt ose rimbursion HN-në.

6.10 Nëse shpenzime të caktuara përcaktohen t'i takojnë më shumë se një shteti, këto shpenzime mund të identifikohen si shpenzime të përbashkëta dhe, nëpërmjet marrëveshjes së përbashkët të shteteve të përfshira, mund të ndahen në pajtim me formulën e ndarjes së shpenzimeve të aprovuara në TA ose dokumente të tjera pasuese.

6.11 Detyrimet për materialet dhe shërbimet civile dhe ushtarake të dhëna nga HN-ja nuk vendosen me një normë më të lartë se ato që u ngarkohen Forcave të Armatosura të HN-së dhe nuk përfshijnë shpenzime të tepërta administrative ose të tjera, por mund të reflektojnë përshtatje për shkak të grafikëve të dorëzimit, pikave të dorëzimit ose konsideratave të ngjashme. Rimbursimi nuk paguhet për mbështetjen e dhënë nga personeli ushtarak.

6.12 Komandanti i NATO-s dhe SN-të mund të kontraktojnë drejtpërdrejt me furnitorët tregtarë për furnizime, shërbime ose mbështetje tjetër.

6.13 Automjetet në pronësi të NATO-s dhe automjetet ushtarake të SN-së janë të vetësiguruara dhe si të tilla mund të operojnë pa siguracion tregtar.

6.14 HN-ja nuk shkakton asnjë detyrim financiar në emër të Komandantit të NATO-s ose SN-së, përveç kur i kërkohet specifikisht ta bëjë këtë paraprakisht nga një përfaqësues i autorizuar dhe përveç kur është rënë dakord për përgjegjësinë për pagesën e shpenzimeve. Për më tepër, asnjë fond nuk jepet para se Komandat Supreme ose SN-të, sipas rastit, të kenë aprovuar dokumentet përkatëse mbështetëse dhe të kenë udhëzuar zbatimin e tyre.

6.15 Në lidhje me këtë MOU nuk është dhënë financim dhe ky dokument nuk përfaqëson ndonjë detyrim specifik financimi nga ana e Komandantit të NATO-s ose SN-ve. Masat e hollësishme financiare dhe procedurat e rimbursimit do të specifikohen në dokumentet pasuese të këtij MOU-je.

6.16 Caktimi i vendeve operationale, në mbështetje të një aktiviteti ushtarak të NATO-s, nuk parashikon ndërtim ose rehabilitim infrastrukture.

SEKSIONI I SHTATË

KONSIDERATA JURIDIKE

7.1 Komandat Supreme realizojnë ose mund të delegojnë veprime juridike që janë thelbësore për përmbushjen e misionëve, duke përfshirë, pa u kufizuar, në ushtrimin e kapacitetit për të lidhur kontrata, për të angazhuar në procedime gjyqësore ose administrative dhe për të përfutur dhe për të disponuar mbi pronën.

7.2 Statusi i forcave të angazhuara në territorin e HN-së do të përcaktohet në pajtim me NATO/PfP SOFA, Protokollin e Parisit dhe/ose Protokollin tjetër Shtesë.

7.3 Pretendimet jokontraktuale që rrjedhin ose janë në lidhje me ekzekutimin e këtij MOU-je trajtohen në pajtim me dispozitat e NATO/PfP SOFA.

7.4 Pretendimet kontraktuale trajtohen dhe gjykohen nga HN-ja në pajtim me procedurën që rregullon kontratat publike dhe në pajtim me ligjin e HN-së, me rimbursim nga Komanda e NATO-s ose SN-ja, sipas rastit.

SEKSIONI I TETË

MBROJTJA E FORCËS

8.1 FP-ja e plotë dhe efektive planifikohet për Komandën statike të NATO-s dhe të gjitha aktivitetet ushtarake të ngjashme dhe detajohet në OPLANS, (EXPIs) ose masat plotësuese, sipas rastit. FP-ja zbatohet në pajtim me politikën dhe procedurat e NATO-s dhe në një mënyrë që është në pajtim me NATO/PfP SOFA. FP-ja nuk kërkohet në asnjë rrethanë të jetë në kundërshtim me NATO/PfP SOFA ose ligjet e HN-së.

8.2 Sipas rastit, HN-ja do të informojë SN-në dhe Komandantin e NATO-s për masat dhe kufizimet e propozuara për FP-në.

8.3 Sipas rastit, çdo SN është përgjegjës për identifikimin dhe paraqitjen e kërkesave dhe kufizimeve të FP-së të HN-ja dhe Komandanti i NATO-s.

8.4 Përveç këtyre përgjegjësi të FP-së, të detajuara në politikën dhe procedurat e NATO-s për FP-në, Komandanti i NATO-s është përgjegjës për bashkërendimin e për gjithçka që kërkohet dhe paraqitet për HN dhe SN FP, sipas rastit, për mbrojtjen e forcës së tij.



SEKSIONI I NËNTË

SIGURIA DHE DEKLARIMI I INFORMACIONIT

9.1 Informacioni i klasifikuar i ruajtur, i trajtuar, i gjeneruar, i transmetuar ose i shkëmbyer si rezultat i këtij ekzekutimit të këtij MOU-je do të trajtohet në pajtim me Marrëveshjen e Sigurisë ndërmjet qeverisë së Mbretërisë së Suedisë dhe Organizatës së Traktatit Atlantik të Veriut dhe Masës Administrative për Trajtimin dhe Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar të dhënë Suedisë ose të marrëveshjeve pasuese. Ndërmjet shteteve të Aleancës, informacioni i klasifikuar, i ruajtur, i trajtuar, i gjeneruar, i transmetuar ose i shkëmbyer si rezultat i ekzekutimit të këtij MOU-je do të trajtohet në pajtim me C-M (2002) 49, “Siguria brenda Organizatës së Traktatit Atlantik të Veriut”, të datës 17 qershor 2002, në versionin përkatës të autorizuar, duke përfshirë të gjitha shtesat dhe ndryshimet e saj dhe marrëveshjet dhe masat ekzistuese të sigurisë.

9.2 Informacioni i dhënë nga një pjesëmarrës ose SN një tjetri në mirëbesim dhe çdo informacion i tillë i nxjerrë nga një pjesëmarrës ose SN i cili kërkon konfidencialitet ruan klasifikimin e tij origjinal ose i caktohet një klasifikimi që garanton një shkallë të mbrojtjes ndaj deklaratimit, të barabartë me atë që kërkohej nga pjesëmarrësi ose SN-ja.

9.3 Çdo pjesëmarrës dhe SN ndërmerr të gjithë hapat e ligjshëm të mundshëm për ta ruajtur nga deklarimi të gjithë informacionin e shkëmbyer në mirëbesim, përveç kur pjesëmarrësit ose SN-të bien dakord me këtë deklaram.

9.4 Për të ndihmuar në dhënien e mbrojtjes së dëshiruar, çdo pjesëmarrës ose SN e shënon këtë informacion të dhënë tjetrit në mirëbesim me një legendë që tregon origjinën, klasifikimin e sigurisë dhe kushtet e tij të deklarimit, që informacioni ka të bëjë me një aktivitet ushtarak specifik të NATO-s dhe që është dhënë në mirëbesim.

9.5 Vizitat nga personeli do të rregullohen në pajtim me procedurat e specifikuar në C-M(2002)49, i ndryshuar.

9.6 I gjithë informacioni i klasifikuar në pajtim me dispozitat e këtij seksioni do të vazhdojnë të mbrohen në rastin e tërheqjes nga një pjesëmarrës ose me prishjen/përfundimin e këtij MOU-je.

SEKSIONI I DHJETË

HYRJA NË FUQI, KOHËZGJATJA DHE PRISHJA/PËRFUNDIMI

10.1 Ky MOU hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit nga autoritetet suedeze, nëpërmjet të cilit Mbretëria e Suedisë ka njoftuar SHAPE-n që janë përmbytur të gjitha kërkesat e nevojshme për hyrjen e tij në fuqi.

10.2 MOU-ja mbetet në fuqi, përveç kur prishet/përfundohet nga një pjesëmarrës, duke bërë një njoftim me afat gjashtë muaj me shkrim drejtuar të gjithë pjesëmarrësve të tjerë.

10.3 Të gjitha dispozitat e seksioneve 6, 7 dhe 9 mbeten në fuqi në rastin e tërheqjes së një pjesëmarrësi ose pas prishjes/përfundimit të këtij MOU-je deri në përmbyshjen e të gjitha detyrimeve. SN-të përmbyshin të gjitha detyrimet në rastin e prishjes/përfundimit ose tërheqjes.

SEKSIONI I NJËMBËDHJETË

NDRYSHIMI DHE INTERPRETIMI

11.1 Ky MOU mund të ndryshohet ose të modifikohet me shkrim me pëlqimin reciprok të të gjithë pjesëmarrësve.

11.2 Ky MOU nuk është i destinuar të jetë në mospërputhje me të drejtën e brendshme ose detyrimet ndërkombëtare të cilave u nënshtrohen pjesëmarrësit. Në rastin konflikti, zbatohet ligji i zbatueshëm i brendshëm dhe/ose detyrimet ndërkombëtare. Pjesëmarrësit njoftojnë njëri-tjetrin në rast konflikti të lindur nga ky MOU.

11.3 Konfliktet e dukshme në interpretimin dhe zbatimin e këtij MOU-je zgjidhen me konsultime ndërmjet pjesëmarrësve në nivelin më të ulët të mundshëm dhe nuk i referohet asnjë tribunalit kombëtar ose ndërkombëtar apo pale të tretë për zgjidhje.

11.4 Ky MOU është nënshkruar në tri kopje në gjuhën angleze.

Sa më sipër përfaqëson marrëveshjet e arritura ndërmjet qeverisë së Mbretërisë së Suedisë dhe Komandave, Komandës Supreme Aleate për Transformimin, si dhe Komandës Supreme të Fuqive Aleatë në Evropë, për çështjet e referuara në të.

Për qeverinë e Mbretërisë së Suedisë
(nënshkrimi)

SVERKER GORANSON

GJENERAL, USHTRIA SUEDEZE

KOMANDANT SUPREM

Datë 4 shtator 2014



Deklarim i Mbretërisë së Suedisë

Për qëllimet e këtij MOU-je dhe dokumentet pasuese, qeveria e Mbretërisë së Suedisë nuk i njeh kontraktuesit si pjesë të forcës ose komponentit civil, sipas përkufizimit në NATO/PfP SOFA dhe Protokollin e Parisit/Protokollin tjetër Shtesë.

Për Komandën Supreme të Fuqive Aleate në Evropë

dhe për Komandat, Komanda Supreme Aleate për Transformimin

(nënshkrimi)

PHILIP M. BREEDLOVE

GJENERAL, FORCA AJRORE TË SHBA-Së
KOMANDA SUPREME ALEATE NË
EVROPE

Datë 4 shtator 2014

Deklaratë e Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Evropë

Deklarimi i Mbretërisë së Suedisë kuptohet të jetë i zbatueshëm në masën që aktivitetet ushtarake të NATO-s mbeten funksionale në pajtim me mandatin/et e Këshillit Atlantik të Veriut.

NATO E PAKLASIFIKUAR

ANEKSI A

DOKUMENTET E REFERUARA

a) Traktati Atlantik i Veriut, i datës 4 prill 1949.

b) Dokumenti Kuadër i Partneritetit për Paqe i lëshuar nga krerët e shteteve dhe qeverive që marrin pjesë në mbledhjen e Këshillit Atlantik të Veriut (Dokument i Kuadër), i datës 10 janar 1994.

c) Marrëveshje ndërmjet Palëve të Traktatit Atlantik të Veriut në Lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (NATO-SOFA) të datës 19 qershor 1951.

d) Protokolli mbi Statusin e Komandave Ushtarake Ndërkombëtare të ngritura në pajtim me Traktatin Atlantik të Veriut, (Protokolli i Parisit), i datës 28 gusht 1952.

e) Marrëveshje ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin Atlantik të Veriut dhe shteteve të tjera që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, në lidhje me Statusin Forcave të tyre (PfP SOFA), të datës 19 qershor 1995.

f) Protokolli Shtesë i Marrëveshjes ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin Atlantik të Veriut dhe

shteteve të tjera që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, në lidhje me statusin e forcave të tyre (Protokolli Shtesë i PfP SOFA), i datës 19 qershor 1995.

g) Protokolli tjetër shtesë i Marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin Atlantik të Veriut dhe shteteve të tjera që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, në lidhje me statusin e forcave të tyre (Protokolli tjetër Shtesë), i datës 19 dhjetor 1997.

h) Marrëveshje sigurie ndërmjet qeverisë së Suedisë dhe Organizatës së Traktatit Atlantik të Veriut, datë 6 shtator 1994

i) Masë Administrative për Trajtimin dhe Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar të NATO-s të dhënë Suedisë, datë 14 qershor 2012;

j) MC 319/1, Parimet dhe Politikat e NATO-s për Logjistikën.

k) MC 334/2, Parimet dhe Politikat e NATO-s për Mbështetjen e Shtetit Pritës (HNS).

l) NATO STANAG-e të zbatueshme dhe Direktivat Politike për Mbështetjen Logjistike, Mbrojtjen e Forcës dhe Rimbursimin Financiar.

m) C-M (2002) 49, Siguria brenda NATO-s, datë 17 qershor 2002.

n) BI-SC Direktiva 15-3 Përgatitja e Marrëveshjeve Ndërkombëtare

o) AJP-4.5 (B), Doktrina e Përbashkët e Aleatëve për Procedurat dhe Mbështetjen e Shtetit Pritës.

p) C-M (2002) 50, Masat Mbrojtëse për Organet Civile dhe Ushtarake të NATO-s, Forcat dhe Instalimet (Asetet) e Angazhuara të NATO-s kundër Kërcënimeve Terroriste.

q) BI-SC Direktiva për Mbrojtjen e Forcës 80-25, 1 janar 2003.

r) BI-SC Udhëzim Planifikimi Funkcional për Mbrojtjen e Forcës.

s) AAP-6, Fjalori i Termave dhe i Përkufizimeve të NATO-s



NOTË ADERIMI

**PËR TË MARRË PJESE NË
MBËSHTETJEN E SHTETIT PRITËS
DHE PËRGJEGJËSITË FINANCIARE
DHE TË TJERA TË KAKTUARA
BRENDA MBRETËRISË SË SUEDISË
(HN) PËR OPERACIONIN/
STËRVITJEN DHE AKTIVITETIN
TJETËR USHTARAK TË NGJASHËM**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (SN) i përfaqësuar nga PUK-u i Shqipërisë në SHAPE, Kapiten i Rangut të I Adnand Agastra,

pasi ka vendosur që Forcat e tij të Armatosura do të marrin pjesë në stërvitje/operacione, në lidhje me aktivitetet për sa i takon Planit të Veprimit të Gatishmërisë së aprovuar nga Këshilli Atlantik të Veriut;

duke marrë parasysh Konceptin e Përgjithshëm të Operacionit/Stërvitjes së NATO-s brenda doktrinës së NATO-s; dhe

me dëshirën për të marrë pjesë në masat në lidhje me mbështetjen e shtetit pritës dhe përgjegjësitë financiare dhe të tjera të **Mbretërisë së Suedisë** (shteti pritës), Komandës Supreme e Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) dhe Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT) dhe shtetet e tjera dërguese, në lidhje me mbështetjen e këtyre forcave të armatosura gjatë stërvitjeve dhe operacioneve në lidhje me aktivitetet për sa i takon Planit të Veprimit të Gatishmërisë,

zgjedh të marrë pjesë dhe të respektojë dispozitat e përfshira në:

“Memorandumin e Mirëkuptimit (MOU) ndërmjet qeverisë së Mbretërisë së Suedisë dhe Komandës Supreme Aleate për Transformimin dhe Komandës Supreme e Fuqive Aleate në Evropë, në lidhje me dhënien e Mbështetjes së Shtetit Pritës për Kryerjen e Operacioneve/Stërvitjeve/Aktiviteteve Ushtarake të Ngjashme”, që ka hyrë në fuqi në 23 qershor 2016, si më poshtë:

Si shtet dërgues për aktivitetet ushtarake në lidhje me angazhimet në lidhje me Planin e Veprimit të Gatishmërisë nëpërmjet MOU-së së sipërpërmendur.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

PUK i Shqipërisë në SHAPE, Kapiten i Rangut të I Adnand AGASTRA

.....
Datë 24.5.2018

VENDIM

Nr. 674, datë 7.11.2018

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.
1128, DATË 5.8.2008, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE
ADMINISTRIMIN E MALLRAVE
REZERVË MATERIALE
SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 5, të ligjit nr. 9900, datë 10.4.2008, “Për rezervat materiale të shtetit”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 1, “Lista e mallrave rezervë materiale shtetërore, sipas grupeve, e ndarë në lloje dhe sasi”, bashkëlidhur vendimit nr. 1128, datë 5.8.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Në tabelën e grupit C, pas numrit rendor 20 shtohen numrat rendorë 21 e 22, me këtë përmbajtje:

21.	Ushqim i koncentruar (koncentrat) për kafshët	ton	120	60
22.	Ushqim voluminoz (bar i thatë dhe kashtë) për kafshët	ton	180	90

2. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 675, datë 7.11.2018****PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 511, DATË 10.6.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “NYJA LIDHËSE MILOT-LEZHË, MILOT-RRËSHEN DHE MILOT-THUMANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 511, datë 10.6.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

a) Pas tabelës së përmendur në pikën 3 shtohet tabela 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1 Vlerës totale të shpronësimit për pasuritë e llojit “objekte”, “tokë arë” dhe “kultura bujqësore e drufrutorë” i shtohet shuma prej 4 430 550 (katër milionë e katërqind e tridhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekësh, e cila ndahet, si më poshtë vijon:

a) Vlera prej 3 212 434 (tre milionë e dyqind e dymbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e katër) lekësh, për pasurinë e llojit “objekte”;

b) Vlera prej 228 516 (dyqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekësh, për pasurinë e llojit “tokë arë”, me sipërfaqe 822 (tetëqind e njëzet e dy) m²;

c) Vlera prej 989 600 (nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind) lekësh, për pasurinë e llojit “kultura bujqësore e drufrutorë”.”.

c) Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1 Vlera totale e shpronësimit, prej 4 430 550 (katër milionë e katërqind e tridhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekësh, do të përballohet nga buxheti i vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, zëri “Shpronësime”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.”.

ç) Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1 Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, do të përballohet nga buxheti i vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.”.

d) Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1 Shpronësimi të fillojë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Tabela 2

LISTA EMËRORE E PRONARËVE (SHITESË) QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR
“NYJA LIDHËSE MILOT–LEZHË, MILOT–RRËSHEN DHE MILOT–THUMANË”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Numri i pasurisë	Sip. totale	Sip. e shpronësuar sipas VKM-së nr. 511, datë 10.6.2015	Tokë arë			Objekt		Vlera e kult. bujq. dhe drufrutorët (lekë)	Vlera totale (lekë)	Shënime
								Sip. m ²	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera, lekë	Sip. ndër. konf. ZVRPP (m ²)	Vlera sipas preventivit			
1	Mark	Gjon	Tarazhi	1677	29/54	3370	3370						471,000	471,000	Konfirmuar nga DRBL-ja
2	Gjon	Preng	Tarazhi	3441	3/27	3456	3256						518,600	518,600	Konfirmuar nga DRBL-ja
3	Gjon	Preng	Tarazhi	3441	2/1-ND						120	3,212,434		3,212,434	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Dile	Gjin	Gjeta	3441	3/28	822		822	278	228,516				228,516	Certifikatë pronësie
Vlera totale e shpronësimit													4,430,550		

Shënim: 1. Vlerësimi i kulturave bujqësore e drufrutorë është kryer bazuar në udhëzimin nr. 1, datë 5.10.2000.

2. Vlerësimi i objektit është kryer bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000.

3. Vlerësimi i pasurisë së llojit “tokë arë” është kryer bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.

**VENDIM****Nr. 676, datë 7.11.2018**

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË
STATUSIT NGA KATEGORIA E
RESURISIT “TOKË BUJQËSORE” NË
“TOKË URBANE” (TRUALL), TË
PASURIVE ME NUMËR 265/40, ZONA
KADASTRALE 2702, BASHKIA VAU I
DEJËS, NUMËR 121/12, ZONA
KADASTRALE 2375, BASHKIA DURRËS,
DHE NUMËR 355/47 E 355/51, ZONA
KADASTRALE 3196, BASHKIA
ROSKOVEC**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane” (truall), të pasurive me numër 265/40, zona kadastrale 2702, Bashkia Vau i Dejës,

numër 121/12, zona kadastrale 2375, Bashkia Durrës, dhe numër 355/47 e 355/51, zona kadastrale 3196, Bashkia Roskovec, sipas lidhjes nr. 1, certifikatave të pasurisë dhe hartave treguese, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, përkatësisht në qarqet Shkodër, Durrës dhe Fier, të pasqyrojnë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit, nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane” (truall), të pasurive me numër 265/40, zona kadastrale 2702, Bashkia Vau i Dejës, numër 121/12, zona kadastrale 2375, Bashkia Durrës, dhe numër 355/47 e 355/51, zona kadastrale 3196, Bashkia Roskovec.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Shkodër, Këshilli i Qarkut Durrës, Këshilli i Qarkut Fier, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama****Lidhja nr. 1**

Nr. rendor	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i pasurisë	Sipërfaqja totale (m ²)	Sipërfaqja ndërtimore (m ²)	Pronari
1	Shkodër	Vau i Dejës	2702	Mjedë	265/40	7574	908	Hysni Brahimi
2	Durrës	Durrës	2375	Lalëz	121/12	3375	248	Arben Keta Pranvera Keta
3	Fier	Roskovec	3196	Roskovec	355/47	2000	1185	Fatmir Sopiku
4	Fier	Roskovec	3196	Roskovec	355/51	3700		Ervin Sopiku



Ruzhdi Dibra
Digitally signed by Ruzhdi Dibra
Date: 2018.01.02 15:25:51
+01'00'

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 1733121
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. SHKODËR Zona Kadastrale Nr. 2702

Numri i Pasurisë 265/40 Volumi 8 Faqe 190

Adresa e Pasurisë MJEDE

Lloji i Pasurisë ARE

Sipërfaqja Totale 7574.50 m2

Nga kjo : Sa Truall _____ Nga kjo : Sa Ndërtesa _____

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes _____ %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)				
Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
HYSNI	ALI	BRAHIMI	1/1	SHKODËR

- është pronar i _____ pasurisë me numër 265/40

- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart _____

- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____

- kufizimet e pasurisë janë: V _____, L _____, J _____, P _____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t)

më datë 1/8/2017 Nr. 13261

Data e lëshimit të çertifikatës 9/8/2017

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
ILIR DIBRA



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

Ruzhdi
DibraDigitally signed by
Ruzhdi Dibra
Date: 2018.01.02
15:28:33 +01'00'LIRIA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
SHKODER

REGJISTRUES



Vula / Firma

A.IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 2702NR.PASURISE 265/40VOL BFQ 190INDEKSI I HARTES SH - K - 76 - (4 - B) (5 - A) SHKALLA 1:2500ADRESA E PASURISE: Rrethi SHKODER Q/F MJEDE

Rr/L : P/G Sh K Ap

B.KUFIZIMET

V 437L 265/38J 446P 265/35

C.PRONARI

HYSNI BRAHIMI

S = 7574.5 m2

D. Data : 09/08/2017

Ora : 01:21:05 PM





Henri
Mahmutllari

Digitally signed by
Henri Mahmutllari
Date: 2017.06.21
17:18:56 +02'00'



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

CERTIFIKATË PËR VËRTETIM PRONËSIE

1115250

Zyra e Regjistrimit DURRES Zona Kadastrale Nr. 2375
 Numri i Pasurisë 121/12 Volumi 10 Faqe 162
 Adresa e Pasurisë CALEZ
 Lloji i Pasurisë ARE
 Sipërfaqja Totale 3375 m²
 Nga kjo : Sa Truall _____ Nga kjo : Sa Ndërtesa _____
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes _____ %

KJO CERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zot (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
<u>AKBEN</u>		<u>KETA</u>	<u>B</u>	<u>CALEZ</u>
<u>PRANVERA</u>		<u>KETA</u>	<u>B</u>	

është pronar i _____
 janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart 121/12
 është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
 kufizimet e pasurisë janë : V 121/11 , L 25 , J 121/4 , P 122

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me
Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të
Paluajtshme.

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së
paraqitur nga i (të) interesuari (t)
më datë 31.02.19 Nr. 11440

Data e lëshimit të certifikatës

02.08.2014





HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME

DURRES

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 2375 NR.PASURISE 121/12 Vol. 10 FQ. 162

INDEKSI I HARTES K-34-88-(114-A) SHKALLA 1:2500 SIP = 3375 m²

ADRESA E PASURISE : Rrethi Durres 0/F LALCZ

Rr/L — P/G — Sh — K — Ap —

C. PRONARI

REGJISTRUESI I RRETHIT

B. KUFIZIME

V. PASURIA Nr 121/11

L. PASURIA Nr 25

J. PASURIA Nr 121/4


P. PASURIA Nr 122

D. Data 04 / 08 / 2014 Ora 12⁰⁰

ARBEN KETA *ef.*

JURGIS CYRREJA
Z.V.R.P.P
DURRES

Elham Baruti





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 161957
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit FIER Zona Kadastrale Nr. 3196
 Numri i Pasurisë 355/47 Volumi 15 Faqe 38
 Adresa e Pasurisë FIER, ROSKOVEC
 Lloji i Pasurisë ARE
 Sipërfaqja Totale 2000 M²
 Nga kjo : Sa Truall _____ Nga kjo : Sa Ndërtesa _____
 Nga pallat : Kuota e pjesëmarrjes _____ %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)		Pjesa	Adresa
Emri	Atësia	Mbiemri	
<u>FATMIR</u>	<u>HYSEN</u>	<u>SOPIKU</u>	<u>B</u>
<u>ERVIN</u>	<u>HYSEN</u>	<u>SOPIKU</u>	<u>D</u>

- është pronar i _____
 - janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart NE PASURINE 355/47
 - është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
 - kufizimet e pasurisë janë : V. P. 355/47, L. P. 355/48, J. P. 355/49, P. P. 355/50

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 28.12.2008 Nr. 19251

Data e lëshimit të çertifikatës 05.01.2010

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
OTMORR ALLKUSHI

Z. V. ...
FIER



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT (Fragment)

**ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME**

FIER

TOMORR ALLKUSHI

Vula



A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 355/6 NR. I PASURISE 355/49 Vol. 15 Fq. 36
 INDEKSI I HARTES K-34-112-(200-A)/SHKALLA 1:2500
 ADRESA E PASURISE: Rrethi FIER Q/E ROSKOVEC
 Rr/L _____ P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____


B. KUFIZIMET

V. P. 355/49
 L. P. 355/48
 J. P. 355/7
 P. P. 355/7

C. PRONARI/ET

"B"

D. Data: 29/12/2009 Ora: 10:00





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË
PËR VËRTETIM PRONËSIE

170864

Zyra e Regjistrimit FIER Zona Kadastrale Nr. 3196
 Numri i Pasurisë 355/51 Volumi 15 Faqe 66
 Adresa e Pasurisë FIER, ROSKOVEC
 Klori i Pasurisë ARË
 Sipërfaqja Totale 3700 M²
 Nga kjo : Sa Truall — Nga kjo : Sa Ndërtesa —
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes — %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zot (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
<u>FATMIR</u>	<u>HYSEN</u>	<u>SOPIKU</u>	<u>B</u>	<u>FIER, ROSKOVEC</u>
<u>ERVIN</u>	<u>HYSEN</u>	<u>SOPIKU</u>	<u>B</u>	

- është pronar i —
 - janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart PASURISË 355/51
 - është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi —
 - kufizimet e pasurisë janë : V P. 355/4 , L P. 355/52 , J P. 355/47 , P P. 355/7

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 22.06.2009 Nr. 12826

Lëshuesi i certifikatës
REGJISTRUESI
(TOFTORR ALLKUSHI)

Data e lëshimit të certifikatës
03.07.2009



HARTA TREGUESË E REGJISTRIMIT

ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME

FIER

TOMORR ALLKUSHI

NOTER
FIER

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 3196 NR. I PASURISE 355/51 V. 15 Fq. 66INDEKSI I HARTES K-34-112-(200A) SHKALLA 1:2500ADRESA E PASURISE: Rrethi FIERE QF ROSKOVETR/L - PG - Sh - K 70

B. IKUFIZIMET

V. P. 355/9L. P. 355/52J. P. 355/47P. P. 355/7


C. PRONAR/ET

FATMIR SOPRIKU

ERVIN SOPRIKU

D. Data: 03/07/2008Ora: 10:30

ROSKOVET



**UDHËZIM****Nr. 764, datë 2.11.2018****PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 542, DATË 21.7.2010,
“KRITERET SPECIFIKE QË DUHET TË
PLOTËSOJNË SUBJEKTET E
SPECIALIZUARA PËR PAJISJEN ME
AUTORIZIM PËR PËRDORIM CIVIL
TË LËNDËVE PLASËSE”**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, të nenit 12, të ligjit nr. 9126, datë 29.7.2003, “Për përdorim civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të pikës 2b, 4a dhe 7b, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 315, datë 5.5.2010, “Për procedurën e dhënies së autorizimit të përdorimit civil të lëndëve plasëse”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 542, datë 21.7.2010, “Për kriteret specifike që duhet të plotësojnë subjektet e specializuara për pajisjen me autorizim për përdorim civil të lëndëve plasëse”, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës I, të shtohet pika I/I, me përbërje si më poshtë:

“I/I Subjektet e licencuara në fushën hidrokarbure dhe të cilat për realizimin e veprimtarisë së tyre e kanë të domosdoshme përdorimin e lëndëve plasëse, mund të kryejnë këto operacione me anë të kontraktimit me subjekteve e specializuara të autorizuar për përdorim të lëndëve plasëse në fushën e veprimtarisë së tyre. Subjektet e specializuara, të cilët kërkojnë që të pajisjen me autorizim “Për përdorim civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, për kryerjen e operacioneve hidrokarbure, në përputhje me kërkesat e ligjit 7746/1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 315, datë 5.5.2010, si dhe kriteret specifike si më poshtë:

1. Të dhëna të përgjithshme për personelin inxhiniero-teknik të kualifikuar nga ana profesionale për të cilin kërkohet:

a) Personelin inxhiniero-teknik duhet të ketë njohuri dhe të ketë realizuar veprimtari të mëparshme në kryerjen e operacioneve hidrokarbure.

b) Kontratë punë e noterizuar me drejtuesin teknik, për punët me lëndë plasëse, si dhe

fotokopjen e noterizuar të diplomës së drejtuesit teknik, i cili duhet të ketë certifikatën e lejes profesionale të tipit A5, dhënë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 551, datë 18.6.2015, “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure”.

c) Kontratë punë me zjarrmëtarin dhe fotokopjen e noterizuar të dëshmisë së tij.

ç) Kontratë për sigurimin e punonjësve, të punësuar në veprimtarinë përkatëse.

2. Personeli inxhiniero-teknik duhet të jetë i aftë nga gjendja shëndetësore për të kryer aktivitet me lëndë plasëse nëntoke e sipërfaqe.

3. Personeli inxhiniero-teknik duhet të ketë vendbanim në Republikën e Shqipërisë.

4. Subjekti i interesuar duhet të ketë pajisjet teknike-teknologjike për kontrollin teknik dhe shpërthimin e ngarkesave me lëndë plasëse, në përputhje me natyrën e tyre.

5. Personeli inxhiniero teknik nuk duhet të ketë kryer vepra penale.

6. Autorizimi për përdorim civil të lëndës plasëse i jepet subjektit të interesuar në emër të drejtuesit teknik.”.

2. Pika II, për “Kushtet që duhet të plotësojë stafi teknik dhe specialistët e huaj”, të ndryshojë si më poshtë:

“a) Duhet të jenë me banim në Republikën e Shqipërisë.

b) Duhet të ketë leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë.

c) Duhet të ketë leje punësimi në Republikën e Shqipërisë, sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar.

d) Duhet të jenë të aftë nga gjendja shëndetësore për të kryer aktivitet me lëndë plasëse nëntokë e sipërfaqe.

e) Nuk duhet të ketë kryer vepra penale.

f) Duhet të jenë të pajisur me diplomë të inxhinierit të minierës ose të industrisë së hidrokarbureve, si dhe të kenë eksperiencë pune nëntokë apo në industrinë e hidrokarbureve minimalisht 3 vjet.

g) Duhet të jenë të licencuar nga AKBN-ja, “Në projektim, vlerësim, konsulencë, monitorim dhe zbatim (drejtim teknik) në fushën e shfrytëzimit të veprimtarisë minerare në zbatim të vendimit të



Këshillit të Ministrave nr. 966, datë 2.7.2009 apo sipas kërkesave të nenit 13/4, të ligjit 7746/1993 dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 551, datë 18.6.2015.

h) I gjithë dokumentacioni duhet në gjuhën shqipe ose i përkthyer dhe i noterizuar.”

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjikhuri

VENDIM
Nr. 224, datë 26.10.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
MIRATIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT
TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR VITIN 2019**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 21, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 19, pika 1, germa “c”, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 26.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike mbi fillimin e procedurave për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2019,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 6879 prot., datë 4 tetor 2018 (protokolluar në ERE me nr. 634 prot., datë 5.10.2018), OST sh.a., ka përgatitur llogaritjen e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2019, sipas materialit që shoqëria i ka bashkangjitur kësaj shkrese.

- Në kapitullin e parë, paraqitet një informacion i përgjithshëm rreth OST sh.a. ku listohen në mënyrë të detajuar përgjegjësitë kryesore të OST sh.a. që burojnë nga aktet ligjore, nënligjore dhe ato rregullatore në fuqi, të tilla si: operimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i rrjetit të transmetimit duke përfshirë interkoneksionet me vendet e tjera kufitare.

- Në kapitullin e dytë të aplikimit, flitet për nivelin e synuar të të ardhurave që kërkohen prej

tarifës së transmetimit, e cila synon të mbledhë të ardhurat për të zhvilluar investimet e nevojshme në sistem, për të përballuar kostot operative të drejtimit të shoqërisë, si dhe për të minimizuar humbjet në sistemin e transmetimit.

- Kapitulli i tretë i aplikimit flet për pritshmëritë e situatës energjetike për vitin 2018. Sipas këtij parashikimi, energjia që pritet të livrohet në rrjetin e OST sh.a. për vitin 2018 është 9,852 gwh ndërsa ajo e planifikuar për vitin 2019 është 7,337 gwh. Këtu OST sh.a. bazohet në të dhënat historike, si dhe duke konsideruar rritjen e mundshme të numrit dhe volumit të konsumatorëve të kualifikuar, si dhe sasinë e energjisë së nevojshme për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit.

- Në kapitullin e katërt të aplikimit OST sh.a., parashikon kërkesën për energji për vitin 2019, si dhe mënyrën e mbulimit të saj. Në bazë të të dhënave të paraqitura nga OST sh.a. gradienti i rritjes së kërkesës për energji elektrike në shkallë vendi mbi baza vjetore është i rendit rreth 1.8%.

- Në kapitullin e pestë OST sh.a., përshkruan funksionet dhe përgjegjësitë e Operatorit të Tregut (OT), për të cilin thotë që është pjesë e strukturës së OST sh.a. në nivel departamenti.

- DOT (Departamenti i Operatorit të Tregut), administron regjistrin e palëve të tregut, si dhe ndjek procedurat përkatëse të regjistrimit të tyre mbështetur në Rregullat e Tregut (RRT) dhe Kodin e Sistemit të Transmetimit (KST).

- Në kapitullin e gjashtë, shoqëria ka përshkruar në vija të përgjithshme zhvillimet në tregun e energjisë balancuese dhe humbjeve në rrjet.

- Për vitin 2019, humbja e energjisë në rrjet është vlerësuar në rreth 179 milionë kwh. Kjo sasi energjie do të blihet me bazë tregu dhe, bazuar në të dhënat e HUPLEX-it, është konsideruar çmimi mesatar vjetor prej rreth 60 €/mwh. Fondi që kërkohet për blerjen e kësaj sasive energjie është rreth 1,4 miliardë lekë.

- Në kapitullin e shtatë, OST sh.a. ka paraqitur llogaritjen e tarifës së shërbimit transmetimit për vitin 2019 ku përfshihen kostot kapitale dhe kostot operative, me 3 variante, si më poshtë:



Metodologjia e llogaritjes së tarifave të transmetimit			Viti 2019			
I.	Pershkrimi Niveli I synuar I të ardhurave (I+II+III)	Njësia Milion Leke	Version 1	Version 2	Version 3	
			Metodologjia	Mospagesa e huave	Mospagesa e huave, Marrja e Shërbimeve ndihmëse nga KESH	
			C = C kapital + C operuese - Të ardhurat nga alokimi i kapaciteteve	9,952	6,835	6,035
II.	C kapital = R+D		6,069	2,952	2,952	
1	Kthimi mbi kapitalin (R = B*wacc)	Milion Leke	3,617	500	500	
	a. B (Baza e rregulluar e aseteve)	**	47,722	47,722	47,722	
	b. WACC = [ES * ARoE/ (1-T)] + (DS * CoD)	%	7.58%	1.05%	1.05%	
	ES - Objektivi për raportin e kapitalit të vet në RAB	**	58.4%	58.4%	58.4%	
	T - Norma e takses së korporatës	**	15%	15%	15%	
	ARoE - Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse	**	9.6%	1.5%	1.5%	
	DS - Objektivi për raportin e bonxhit në RAB	**	41.6%	41.6%	41.6%	
	CoD - Kosto e bonxhit	**	2.3%	0.0%	0.0%	
	2	Amortizimi i vitit (D)	Milion Leke	2,452	2,452	2,452
	III.	C operuese	**	5,083	5,083	4,283
1	1 Personeli	**	1,380	1,380	1,380	
	2 Shërbime administrative e të tjera	**	620	620	620	
	3 Materiale të para	**	130	130	130	
	4 Blerja e shërbimeve ndihmëse	**	1,000	1,000	200	
	5 Blerja e humbjeve	**	1,400	1,400	1,400	
	6 Pagesë ITC (Inter TSO Compensation mechanism)	**	500	500	500	
	7 Pagesë për organizmat rajonale e europianë	**	50	50	50	
	8 Taksa	**	3	3	3	
III.	Të ardhurat nga alokimi i kapaciteteve	**	(1,200)	(1,200)	(1,200)	
	E - Energjia e transmetuar (OSHEE + të tjera)	GWh	7,158	7,158	7,158	
	Tarifa mesatare e transmetimit	Lek/kWh	1.39	0.95	0.84	
1	$P_{kapacitet} = C_{kapital} / L$ C kapacitet = C kapital - Të ardhurat nga Alokimi L - shuma e kapaciteteve total mujore	Leke/kW/muaj Milion leke kW	279.8 4,869 1,450,000	100.7 1,752 1,450,000	100.7 1,752 1,450,000	
	2	$P_{energji} = C_{operuese} / E$ Coperuese E - Energjia e transmetuar (OSHEE + të tjera)	Leke/kWh Milion leke GWh	0.71 5,083 7,158	0.71 5,083 7,158	0.60 4,283 7,158
	3	$P_{mesatare} (\text{tarifa mesatare e transmetimit}) = (C_{kapacitet} + C_{energji}) / E$	Lek/kWh	1.39	0.95	0.84

- Nuk është paraqitur në ERE, në zbatim të pikës 5, të nenit 60, të ligjit 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, plani i investimeve për vitin 2018 dhe vitin 2019, e më tej në aplikim nuk ka informacion mbi realizimin e këtij plani për vitin 2017 dhe të pritshmin e vitit 2018.

- Nuk janë paraqitur në mënyrë analitike kostot faktike të 9 muajve tashmë të mbyllur të vitit 2018, si dhe parashikimin e pritshëm për pjesën e mbetur të vitit 2018.

- Nuk janë argumentuar në mënyrë analitike, por vetëm përshkruar në mënyrë empirike kostot e pritshme të funksionimit normal të OST sh.a. për vitin 2019, ashtu sikurse përcaktohet në nenin 5, paragrafi 18, të "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike".

- Nuk janë paraqitur në mënyrë të veçantë kostot e funksionimit të operatorit të tregut, pavarësisht se ky operator është ende pjesë e OST sh.a. në nivel departamenti.

- Nuk është paraqitur në mënyrë të detajuar korigjimi i të ardhurave nga periodha e mëparshme rregullatore.

- Mungon analiza e llogaritjes së Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB) për vitet 2015–2018 për të evidentuar dhe për të paraqitur në këtë mënyrë, gjendjen dhe lëvizjet e aseteve të

detajuara krahasuara me pasqyrat financiare përkatëse. Shqyrtimi vështirësohet edhe më tej nga mungesa e planit të investimeve të shoqërisë për vitet 2018 dhe 2019, si dhe nga mungesa e raportimit të investimeve të realizuara për vitin 2018, si dhe investimet faktike për vitin 2017.

- Nuk janë paraqitur vlerat e shërbimeve ndihmëse të realizuara për vitin 2018, e shoqëruar dhe me sqarimet përkatëse në lidhje me kapacitetin faktik të realizuar për vitin 2017 dhe të pritshmin për vitin 2018, për të argumentuar kërkesën e të ardhurave të kërkuara për mbulimin e kostove të parashikuara për vitin 2019. Në lidhje me kostot e këtyre shërbimeve OST sh.a. deklaroi se ka marrë në konsideratë, çmimet e aplikuar nga TSO-të e rajonit pa dhënë referenca të mëtejshme.

- Për sa u përket humbjeve në rrjetin e transmetimit, në aplikimin e saj OST sh.a. ka konsideruar një çmim mesatar vjetor prej 60 eurosh/mwh, duke deklaruar që bazohen në të dhënat e HUPX-it. Në lidhje me këtë referencë do të kërkohej shpjegime dhe argumentime dhe verifikime të mëtejshme, të cilat do të kryhen gjatë procesit të miratimit të tarifës së transmetimit të energjisë elektrike.

- Një pjesë e mangësive të konstatuara më sipër i janë adresuar shoqërisë OST sh.a., me shkresën tonë nr. 654, datë 15 tetor 2018. Deri



më tani nuk kemi informacion shitesë për efekt të aplikimit të OST sh.a. për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2019, por jemi ende në pritje.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2019.

2. Drejtoria Çmimeve dhe e Tarifave të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 225, datë 26.10.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË OST
SHA, PËR DISA NDRYSHIME NË
“RREGULLOREN PËR PROCEDURAT E
BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË
RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË
TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN
DHE SHITJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR
PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE
TË SHËRBIMIT PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 19, germa “I” dhe nenit 56, germa “F”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, dhe “Rregullave të tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të

ERE-s nr. 214, datë 28.12.2017, nenit 19, pika “F” dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e hartuar nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a., për disa ndryshime në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”,

konstatoi se:

- OST sh.a., me shkresën nr. 2167/4 prot., datë 8.10.2018, ka kërkuar nga ERE disa ndryshime në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.

- OST sh.a., me shkresën nr. 2167/4 prot., datë 9.10.2018, ka vijuar korrespondencën lidhur me këto ndryshime, referuar edhe shkresës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë me nr. 28 prot., datë 26.9.2018, nëpërmjet së cilës ka kërkuar rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, të ndryshuar, i cili ka miratuar “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.

- Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë AEES, nuk legjitimohet si palë propozuese për të kërkuar ndryshime në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, ku palë janë OST sh.a. dhe OSHEE sh.a., bazuar në nenet 62 dhe 69 të ligjit nr. Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Kërkesa për interpretim të dispozitave dhe të ndryshime në këtë rregullore është shtruar edhe më herët nga OST sh.a., me shkresat nr.



6393/1, datë 11.12.2017; nr. 2167 prot., datë 11.4.2018 dhe nr. 2167/3 prot., datë 8.5.2018, por ERE, nëpërmjet shkresave nr. 747/2, datë 21.12.2017; nr. 259 prot., datë 13.3.2018 dhe nr. 259/2 prot., datë 18.4.2018, i ka kërkuar OST sh.a. të paraqesë për shqyrtim propozime konkrete të kërkesës për ndryshime.

- OST sh.a. kërkon. që për analogji edhe me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, të mund të konsiderohet i vlefshëm procesi me një ofertë të vlefshme.

- Kjo rregullore paraqet formë të thjeshtëzuar të procedurave të prokurimit publik. Rregullorja është draftuar në konsulencë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë ENC. Gjithashtu, kjo rregullore paraqet procedura edhe për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve nga operatori i shpërndarjes së energjisë OSHEE sh.a. (sot OSSH sh.a.), kështu marrja e opinionit të OSSH sh.a. dhe Sekretariati të Komunitetit të Energjisë ENC. në lidhje me ndryshimet e kërkuara nga OST sh.a. konsiderohet e nevojshme në këtë proces.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. mbi disa ndryshime në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, si më poshtë:

Në nenin 15 të “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, propozohet të shtohet:

- Në rastin e përsëritjes së procesit, procesi të zhvillohet i njëjtë me atë fillestar dhe procedura të përsëritet aq herë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit, të blerjes së sasisë së nevojshme të energjisë.

- Procesi mund të konsiderohet i vlefshëm dhe me një ofertë të vlefshme.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OST sh.a., OSHEE sh.a., AAES dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Faqe| 11136

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 226, datë 26.10.2018

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENER TRADE” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, germa “e”; të nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë “Ener Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 628, datë 3.10.2018, shoqëria “Ener Trade” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 220, datë 11.10.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Ener Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, u publikua në media njoftimi me nr. 55/61 prot., datë 11.10.2018. Po ashtu, me shkresën nr. 628/2 prot., datë 16.10.2018, iu kërkuar subjektit plotësimi i dokumentacionit të munguar që kishte të bënte me nenin 9, pika 2, germa “d” (Vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata), për shoqërinë “Ener Trade” sh.p.k.



- Subjekti, me shkresën nr. 628/1 prot., datë 15.10.2018, ka paraqitur në ERE dokumentacionin e munguar cituar më sipër.

- Aplikimi i shoqërisë “Ener Trade” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1): plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2): plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3): plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9 pika 4.8): plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Ener Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 227, datë 26.10.2018

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENER TRADE” SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “ç” të ligjit nr. 43/2015, “për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, germa “d”, të nenit 5, pika 1, germa “d”, të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në

sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016 dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë “Ener Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 628, datë 3.10.2018, shoqëria “Ener Trade” sh.p.k., ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 221, datë 11.10.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Ener Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u publikua në media njoftimi me nr. 55/61 prot., datë 11.10.2018. Po ashtu, me shkresën nr. 628/2 prot., datë 16.10.2018, iu kërkuar subjektit plotësimi i dokumentacionit të munguar që kishte të bënte me nenin 9, pika 2, germa “d” (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata), për shoqërinë “Ener Trade” sh.p.k.

- Subjekti, me shkresën nr. 628/1 prot., datë 15.10.2018, ka paraqitur në ERE dokumentacionin e munguar, cituar më sipër.

- Aplikimi i shoqërisë “Ener Trade” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1): plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2): plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3): plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7 dhe 4.7.1): plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të licençojë shoqërinë “Ener Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 228, datë 26.10.2018

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“OSOJA HPP” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“OSOJË”, ME FUQI TË INSTALUAR 1952
kw, NË ZONËN E MOGLICËS, KORÇË
(LUMI OSOJË)**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; si dhe të nenit 4, pika 1, germa “a”, të nenit 5, pika 1, germa “a” dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe të nenit 15 të “Rregullore të organizimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi licencimin e shoqërisë “Osoja HPP” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Osojë”, me fuqi të instaluar 1952 kw dhe vendndodhje në zonën e Moglicës, Korçë (lumi Osojë),

konstatoi se:

- Shoqëria “Osoja HPP” sh.p.k., me shkresën me nr. 430 prot., datë 5.6.2018, ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë në

veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Osojë”, me fuqi të instaluar 1922 kw, vendndodhje në zonën e Moglicës, Korçë (lumi Osojë).

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 135, datë 25.6.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Osoja HPP” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Osojë”, me fuqi të instaluar 1952 kw dhe vendndodhje në zonën e Moglicës, Korçë (lumi Osojë).

- ERE, me shkresën nr. 55/40 prot., datë 26.6.2018, bëri njoftimin në median e shkruar, si dhe me shkresën nr. 430/1 prot., datë 3.7.2018, dërgoi pranë subjektit “Osoja HPP” sh.p.k., kërkesën për plotësimin e dokumentacionit të munguar të konstatuar në dosjen e aplikimit, i cili konsiston si më poshtë:

Miratimi nga Ministria e Industrisë dhe Energjisë, për kalimin e të drejtave për ndërtimin e HEC “Osojë”, nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive: “Favina” sh.p.k., “Favina 1” sh.p.k. dhe “Osoja Energy” sh.p.k. te shoqëria “Osoja HPP” sh.p.k.

- Shoqëria “Osoja HPP” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 430/3 prot., datë 19.7.2018, ka përcjellë në ERE një informacion me anë të të cilit bën me dije, se bazuar në nenin 28 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar, është kërkuar pranë MIE-s transferimi i të drejtave të bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Favina” sh.p.k., “Osoja Energy” sh.p.k. dhe “Favina 1” sh.p.k., në lidhje me ndërtimin e HEC “Osojë”, te shoqëria “Osoja HPP” sh.p.k. Sa më sipër, subjekti “Osoja HPP” sh.p.k. ka përcjellë në ERE bashkëlidhur edhe shkresën drejtuar MIE-s me nr. 53 prot., datë 12.7.2018. Shoqëria “Osoja HPP” sh.p.k. ka bërë me dije se do të vërë në dispozicion të ERE-s përgjigjen zyrtarë të MIE-s, sapo ta administrojë atë, dhe për këtë qëllim, në shkresën me nr. 430/6 prot. hyrës, datë 6.9.2018, ka kërkuar shtyrje të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s.

- Për sa parashtruar më sipër, referuar nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin,



rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, në mbledhjen e datës 3.8.2018, paraqiti në Bord, informacionin nr. 65/4 prot., datë 30.7.2018, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Osoja HPP” sh.p.k., për shtyrje të afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s”, kërkesë e cila u pranua duke shtyrë vendimmarrjen e Bordit të ERE-s, lidhur me aplikimin e shoqërisë “Osoja HPP” sh.p.k., për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Osojë”, me 30 ditë pune nga përfundimi i afatit ligjor të përmbylljes së trajtimit të praktikës.

- Në vijim të sa më sipër, me shkresën nr. 430/3 prot, datë 9.8.2018, u njoftua shoqëria “Osoja HPP” sh.p.k., mbi pranimin e kërkesës për shtyrje të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s, lidhur me aplikimin e shoqërisë “Osoja HPP” sh.p.k., për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Osojë”, me fuqi 1952 kwh, vendndodhje në zonën e Moglicës, Korçë (lumi Osojë), duke i bërë me dije se ky afat përfundon në datën 14.9.2018 dhe deri në atë datë duhet të plotësohet i gjithë dokumentacioni i munguar.

- Po ashtu, në datën 3.9.2018, me shkresën nr. 430/5 prot., ERE i është drejtuar me një “Kujtesë” shoqërisë “Osoja HPP” sh.p.k. dhe për dijeni MIE-s, me anë të së cilës rikujton edhe njëherë përfundimin e afatit të shtyrjes së vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s dhe dokumentacionin që duhet plotësuar deri në përfundim të këtij afati. Ndërkohë, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 430/6, datë 4.9.2018, shoqëria “Osoja HPP” sh.p.k. ka kërkuar sërish nga ERE shtyrjen e afatit të vendimmarrjes finale mbi aplikimin e saj, për shkak se është ende duke pritur transferimin nga ana e MIE-s të të drejtave të bashkimit të përkohshëm të shoqërive: “Favina” sh.p.k., “Osoja Energy” sh.p.k. dhe “Favina 1” sh.p.k.

- Në vijim të sa më sipër, në përfundim të afatit të shtyrjes së vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s për licencimin e shoqërisë “Osoja HPP” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, rezulton se dokumentacioni i munguar sipërcituar në këtë relacion dhe shpjegimet përkatëse nuk janë paraqitur nga subjekti.

- Në vijim të sa konstatohet më sipër, Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut në mbledhjen e datës 27.9.2018, paraqiti në Bord, relacionin me nr. 74/7 prot., datë 14.9.2018, “Për refuzimin e licencimit të shoqërisë “Osoja HPP” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Osoja”, me fuqi 1952 kw” dhe vendndodhje në zonën e Moglicës, Korçë (lumi Osojë). Duke marrë në konsideratë faktin se miratimi nga MIE, për kalimin e të drejtave për ndërtimin e HEC “Osojë”, nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive: “Favina” sh.p.k., “Favina 1” sh.p.k. dhe “Osoja Energy” sh.p.k. te shoqëria “Osoja HPP” sh.p.k., përbën një dokument thelbësor për vendimmarrjen finale të Bordit të ERE-s.

- Duke qenë se nga ana e Bordit të ERE-s u ngritën një sërë pyetjesh mbi relacionin nr. 74/7 prot., datë 14.9.2018, “Mbi refuzimin e licencimit të shoqërisë “Osoja HPP” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë nga HEC “Osojë”, me fuqi të instaluar 1952 kw” dhe vendndodhje në zonën e Moglicës, Korçë (lumi Osojë), u përpilua relacioni me nr. 78/1, datë 12.10.2018, në të cilin janë dhënë shpjegimet përkatëse për pyetjet e ngritura.

- Ndërkohë, subjekti “Osoja HPP” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 430/8, datë 22.10.2018, ka përcjellë miratimin e MIE-s, me nr. 7839/4 prot., datë 3.10.2018, me anë të të cilit është miratuar transferimi i të drejtave për ndërtim, me kusht që të mbarten të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratën me nr. 1755 rep., nr. 776/3 kol., datë 25.7.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Osojë”.

- Transferimi i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të bashkimit të përkohshëm të shoqërive: “Favina” sh.p.k., “Osoja Energy” sh.p.k. dhe “Favina 1” sh.p.k., në lidhje me ndërtimin e HEC “Osojë” te shoqëria “Osoja HPP” sh.p.k., dhënë nga MIE, me shkresën nr. 7839/4 prot., datë 3.10.2018, ezauron përmbushjen e dokumentacionit të munguar të këtij aplikimi, si dhe paqartësitë në lidhje me përkatësinë e lejeve, të cilat ishin marrë më parë nga shoqëritë që kanë krijuar “Bashkimin e shoqërive”. MIE ka dhënë miratimin e saj që të gjitha të drejtat dhe detyrimet i kalojnë shoqërisë “Osoja HPP” sh.p.k. ka lënë detyrë që pasi të



kryhet transferimi të pasqyrohet edhe në ekstraktin e QKB-së, si dhe “Osoja HPP” sh.p.k., të paraqitet pranë MIE-s për të amenduar kontratën e koncesionit, mbi ndërtimin e HEC “Osojë”, kontratë e cila duhet të paraqitet edhe në ERE.

- Nga analizimi i dokumentacionit të aplikimit në fazën finale, në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1): plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2): plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3): plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për HEC (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5): plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Osoja HPP” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Osoja”, me fuqi 1952 kw, dhe vendndodhje në zonën e Moglicës, Korçë (lumi Osojë), për një afat 30-vjeçar (tridhjetëvjeçar).

2. Shoqëria “Osoja HPP” sh.p.k. duhet të përcjellë në ERE, ndryshimin e kontratës me nr. 1755 rep., nr. 776/3 kol., datë 25.7.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Osojë”.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 229, datë 26.10.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR SHËRBBIMIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NR. 116 PROT., DATË 2.10.2018, TË LIDHUR NDËRMJET SHOQËRISË “ALBGAZ” SHA DHE SHOQËRISË “ALBPETROL” SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 35 dhe të nenit 36, të ligjit nr. 102/2015, “për sektorin gazit natyror”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe për caktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. dhe “Albgaz” sh.a., si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për shërbimin e transmetimit të gazit natyror të lidhur ndërmjet shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe shoqërisë “Albpetrol” sh.a., me nr. 116, datë 2.10.2018,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 179, datë 8.11.2017, ka certifikuar shoqërinë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror, ‘Albgaz’” sh.a. dhe me vendimin, nr. 90, datë 7.6.2017, ka miratuar tarifën e përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për periudhën 5.1.2017–20.9.2017”, ndryshuar me vendimin nr. 155, datë 28.09.2017.

- Me vendimin, nr. 14, datë 10.1.2018, ka miratuar shtyrjen e afatit të tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 90, datë 7.6.2017, si dhe kontratës së transmetimit të gazit natyror të lidhur mes “Albpetrol” sh.a. dhe “Albgaz” sh.a.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 178, datë 8.11.2017, ka miratuar “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”.



- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 188, datë 10.11.2017, ka licencuar shoqërinë “Albgaz” sh.a., në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. ushtron aktivitetin si Operatori i Kombinuar i Sistemit të Transmetimit dhe të Shpërndarjes së Gazit Natyror në Shqipëri, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. dhe për caktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërisë ‘Albpetrol’ sh.a. dhe ‘Albgaz’ sh.a.”.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 116/1 prot., datë 15.10.2018, protokolluar në ERE me nr. 392/3 prot., datë 16.10.2018, ka kërkuar miratimin e kontratës me nr. 116 prot., datë 2.10.2018, të lidhur ndërmjet shoqërisë “Albpetrol” sh.a. dhe “Albgaz” sh.a., për shërbimin e transmetimit të gazit natyror, për një afat njëvjeçar, duke filluar nga data 1.1.2018–31.12.2018.

- Objekti i kontratës, midis shoqërive “Albgaz” sh.a. dhe “Albpetrol” sh.a., është transmetimi i gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. kundrejt një tarife transmetimi për llogari të shoqëria “Albpetrol” sh.a.

- Kjo kontratë rregullon të gjithë marrëdhënien e shërbimit të transmetimit të gazit natyror ndërmjet palëve duke përfshirë, por pa u kufizuar edhe programin, normimin, livrimin dhe pranimin e gazit natyror për periudhën kohore të përcaktuar në kontratë. Kjo kontratë mund të zgjidhet para afatit me njoftim paraprak me shkrim, nga secila palë 2 (dy) muaj përpara datës së zgjidhjes.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e kontratës me nr. 116, datë 2.10.2018, “Për shërbimin e transmetimit të gazit natyror të lidhur ndërmjet shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe shoqërisë “Albpetrol” sh.a., për një afat njëvjeçar, duke filluar nga data 1.1.2018–31.12.2018.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 230, datë 26.10.2018

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SGD ENERGJI” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “NDËRFUSHAS”, ME FUQI TË INSTALUAR 1125 kw, ME VENDNDODHJE NË ZONËN E BULQIZËS

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe të nenit 4, pika 1, germa “a”; të nenit 5, pika 1, germa “a”; të nenit 8, pika 2 dhe të nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SGD Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ndërfushas”, me fuqi të instaluar 1125 kw dhe vendndodhje në zonën e Bulqizës,

konstatoi se:

- Shoqëria “SGD Energji” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 655 prot., datë 17.10.2018, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ndërfushas”, me fuqi të instaluar 1125 kw dhe



vendndodhje në zonën e Bulqizës, për një periudhë 49-vjeçare.

- Aplikimi i shoqërisë “SGD Energji” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1): plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”): plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5): plotësuar në mënyrë korrekte.

Dokumentacioni i munguar ka të bëjë me:

- Vërtetimet nga Gjykata dhe Prokuroria (neni 9, pika 2, gjerat “d”);

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a” (Vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave); “b” (Paraqitje bilanci financiar të tri viteve të fundit); “c” (Dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit) dhe “d” (Vërtetimin e pagesës së aplikimit në llogari të ERE-s).

- Mungesën e kryerjes së pagesës së aplikimit për licencim përbën një element thelbësor për mosfillimin e procedurës së licencimit.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SGD Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ndërfushas”, me fuqi 1125 kw, me vendndodhje në zonën e Bulqizës.

2. Subjekti mund të paraqesë brenda 30 ditëve një aplikim të ri, sipas nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 233, datë 2.11.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR DISA AMENDIME PËR PROPOZIMIN E TË GJITHA OST-ve, MBI “UDHËZUESIN PËR KËRKESAT ORGANIZATIVE, ROLET DHE PËRGJEGJËSITË, NË LIDHJE ME SHKËMBIMIN E TË DHËNAVE” (KORP)

Në mbështetje të neneve 7; 16; 56 dhe 63, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 40, pika 6, të Rregullores së Komisionit të BE-së 2017/1485, “Mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike (SO GL)”, (*Security of Operation Guideline, or Commission Regulation (EU) 2017/1485 of 2 August 2017 establishing a guideline on electricity transmission system operation*)/Rregullorja e Komisionit të BE-së 2017/1485 ose Udhëzuesi mbi Sigurinë Operacionale); të nenit 26, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe duke konsideruar se Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. është anëtarë me të drejta të plota e ENTISO-E, Bordi i ERE-s, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për miratimin e disa amendimeve për propozimin e të gjitha OST-ve, “Mbi udhëzuesin për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë, në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP), konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 159, datë 9.7.2018, miratoi “Udhëzuesin për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP).

- Në vijim të këtij miratimi, OST sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 674



prot., datë 22.10.2018, ka dërguar për miratim, amendimet për propozimin e të gjithë OST-ve mbi “Udhëzuesin për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP).

- Pas shqyrtimit nga ENTSO-E në cilësinë e hartuesit të KORP-së, në datën 9 tetor 2018, u krye votimi në lidhje me këto amendime, i cili rezultoi në favor të miratimit të tyre.

- KORP-ja është propozim i të gjitha OST-ve të ENTSO-E për kërkesat themelore organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave, draftuar në përputhje me nenin 40, pika 6 të Rregullores së Komisionit të BE-së 2017/1485, “Mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike SO GL” (*Security of Operation Guideline, or Commission Regulation (EU) 2017/1485 of 2 August 2017 establishing a guideline on electricity transmission system operation*/Rregullorja e Komisionit të BE-së 2017/1485 ose Udhëzuesi mbi Sigurinë Operacionale).

- Versioni i amenduar dhe i miratuar i këtij akti është publikuar dhe në faqen zyrtare të ENTSO-E, ku OST sh.a. është anëtare me të drejta të plota.

- Amendimet për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP), janë bashkëlidhur këtij vendimi dhe konsistojnë kryesisht në një sistemim sintaksor dhe leksik më të mirë të strukturës së këtij udhëzuesi, me qëllim kuptimin më të mirë nga ana e palëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e disa amendimeve për propozimin e të gjitha OST-ve mbi “Udhëzuesin për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë, në lidhje me shkëmbimin e të dhënave (KORP). (Drafti me ndryshime bashkëlidhur këtij vendimi.)

2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit shqip.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit do të njoftojë palët e interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 234, datë 2.11.2018

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN TETOR 2018

Në mbështetje të nenit 16, të nenit 86 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 25.6.2018, “Mbi rishikimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.11.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin tetor 2018,

konstatoi se:

- OSHEE sh.a., me anë të shkresës nr. 19972 prot., datë 26.10.2018, paraqiti në ERE në datën 29.10.2018, aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin tetor 2018. Nëpërmjet këtij aplikimi, OSHEE sh.a. kërkon që çmimi i shitjes së energjisë te klientët FMF për muajin tetor 2018 të jetë 14,06 lekë/kwh.

- Informacioni i dërguar në këtë shkresë është përgatitur në mbështetje të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 144, datë 25.6.2018, mbi rishikimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, pikërisht të nenit 8 të rishikuar të



“Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017.

- Duke u mbështetur në formulën përlogaritëse

të nenit 8 të metodologjisë së sipërcituar, OSHEE sh.a. ka përcaktuar çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin tetor 2018, si vijon:

Çmimiper FMF i llogaritur nga OSHEE sh.a. per muajin Tetor 2018			
a.	Çmimi maksimal i blerjes ne treg te parregulluar ose blerja nga prodhuesit me perparesi	9.72	leke/kWh
b.	Kthimi per riskun i percaktuar ne perqindje (3%)	0.29	leke/kWh
c.	Çmimi maksimal i blerjes per periudhen relevante	10.02	leke/kWh
d.	Kosto administrative e Furnizuesit te Mundesise se Fundit	1.79	leke/kWh
e.	Tarifa e perdorimit te rrjetit te transmetimit	0.75	leke/kWh
f.	Tarifa e perdorimit te rrjetit te shperndarjes ne 35 kV	1.5	leke/kWh
Cmimi i energjise aktive (c+d+e+f)		14.06	leke/kWh

- Lidhur me përcaktimin e çmimit maksimal prej 9,72 lekësh/kwh të blerjes për muajin tetor 2018, OSHEE sh.a., ka paraqitur, bashkëngjitur këtij aplikimi, raportimin e Departamentit të Tregtimit të Energjisë Elektrike të OSHEE sh.a., të datës 18.10.2018, mbi realizimin e procedurës së blerjes së energjisë elektrike nga tregu i parregulluar për sistemin e shpërndarjes.

- Konstatohet se OSHEE sh.a., ka përdorur mesataren e ponderuar të çmimeve të blerjes së energjisë elektrike prej 77.7 eurosh/mwh për përcaktimin e “Çmimit maksimal të blerjes së energjisë elektrike për periudhën e furnizimit”, gjë që bie në kundërshtim me vetë përkufizimin e nenit 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, sipas të cilit CBET është çmimi maksimal i blerjes së energjisë për periudhën e furnizimit nga Tregu, i parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi (BRE).

- Nga analiza e raportit mbi blerjet e energjisë, të Departamentit të Tregtimit të Energjisë të OSHEE sh.a., konstatohet se çmimi më i lartë i realizuar për muajin tetor është çmimi prej 92.8 euro/mwh për blerjen e sasisë prej 10.08 gwh nga shoqëria “n4t-group” për fashën orare 07:00–23:00 të periudhës kohore 21.10.2018–31.10.2018. Për rrjedhojë, çmimi 92.8 euro/mw do të konsiderohet për përcaktimin e çmimit për klientët FMF për muajin tetor.

- Për sa deklarohej nga OSHEE sh.a. edhe paraqitet edhe në relacionet e mëparshme të përcaktimit të këtij çmimi, OSHEE sh.a. vazhdon të mos ketë ndarje të llogarive midis aktivitetit të

furnizimit dhe të shpërndarjes dhe vijon të mos ketë ndarje të tyre edhe sot, dhe se “OSHEE nuk ka një strukturë të posaçme për evidentimin e kostove të administrimit dhe kostot e disbalancave për klientët e FMF-së”. Në këto kushte, mendojmë se për përcaktimin e kostove administrative (elementi CA i formulës) është e arsyeshme, që, për sa kohë që nuk ka ndarje të llogarive midis aktiviteteve dhe mungon një strukturë për evidentimin e kostove për klientët FMF, të pranojmë koston për njësi prej 1,79 lekësh/kwh të paraqitur nga OSHEE sh.a., si më sipër.

- Në vijim, me ndarjen administrative/organizative të OSHEE-së, sipas aktiviteteve do të jetë i mundur saktësimi i këtyre kostove dhe axhustimi i tyre për periudhat e mëparshme, në përputhje me “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, miratuar me vendimin nr. 210, datë 28.12.2017, “Për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga ‘OST’ sh.a., për vitin 2018” është 0.75 lekë/kwh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, miratuar me vendimin nr. 190, datë 30.8.2017, “Mbi shtyrjen deri më 31.12.2018 të afatit të vendimit nr. 52, datë 6.4.2017, “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, të Bordit të ERE-s” është 1.5 lekë/kwh.

- Për përcaktimin e kursit të këmbimit u krye verifikimi në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë



për datën 18.10.2018, datë në të cilën është kryer procedura e blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria “n4t-group”. Kursi i këmbimit i përdorur në llogaritjen e çmimit të FMF-së, për muajt tetor 2018 është i njëjtë me atë të paraqitur nga “OSHEE” sh.a., 125,16 euro/mwh;

- Në përfundim, nga verifikimi i informacionit dhe i përlogaritjeve të paraqitura nga shoqëria, rezulton se çmimi për shitjen e energjisë elektrike për klientët në kushtet e FMF-së për muajin tetor 2018 është 16.00 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimin e furnizimit me energji elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, prej 16.00 lekësh/kwh, për muajin tetor 2018.

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 235, datë 2.11.2018

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 196, DATË 30.8.2018, “PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMET E BORDIT
TË ERE-s, NR. 120, DATË 4.6.2018, “MBI
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË
INVESTIMEVE PËR VITIN 2018, TË
SHOQËRISË ‘ALBGAS’ SHA” DHE NR.
121, DATË 4.6.2018, “MBI FILLIMIN E
PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E
PLANIT 10 -VJEÇAR TË ZHVILLIMIT TË
RRJETIT TË SHOQËRISË
‘ALBGAS’ SHA”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 16, pika 12, të neneve 46 dhe 56 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; të nenit

113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; të neneve 8 dhe 9, të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”, si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.11.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për një ndryshim në vendimin nr. 196, datë 30.8.2018, “Për një ndryshim në vendimet e Bordit të ERE-s, nr. 120, datë 4.6.2018, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit të investimeve për vitin 2018 të shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a.” dhe nr. 121, datë 4.6.2018, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 196, datë 30.8.2018, miratoi një ndryshim në vendimet e Bordit të ERE-s nr. 120, datë 4.6.2018, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit të investimeve për vitin 2018 të shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a.” dhe nr. 121, datë 4.6.2018, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a.”, duke shtyrë afatin e përcaktuar në këto vendime për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Sa më sipër, me shkresën nr. 495/2 prot., datë 3.9.2018, ERE ka përcjellë pranë “Albgaz” sh.a. njoftimin e vendimit nr. 196, datë 30.8.2018, të sipërcituar, duke i bërë me dije edhe detyrimin për depozitimin e dokumentacionit të munguar, brenda datës 20.10.2018.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 454/4 prot., datë 16.10.2018, ka kërkuar nga ERE shtyrjen e afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar deri në datën 20.1.2018.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 196, datë 30.8.2018, si më poshtë:

- “Albgaz” sh.a. të depozitojë pranë ERE-s jo më vonë se data 20.1.2019: miratimet nga Këshilli Mbikëqyrës, të Planit të Investimeve për



vitin 2018, që reflektojnë ndryshimet e paraqitura pas shkresës nr. 43 prot. datë 21.3.2018; argumentime më të detajuara lidhur me projektet.

2. Të miratojë ndryshimin e pikës 2, të vendimit nr. 196, datë 30.8.2018, si më poshtë:

- “Albgaz” sh.a. të depozitojë pranë ERE-s, jo më vonë se data 20.1.2019: miratim nga Këshilli Mbikëqyrës të Planit të Zhvillimit të Rrjetit për periudhën 1018–2027, që reflekton ndryshimet e paraqitura pas shkresës nr. 43 prot., datë 21.3.2018; argumentime më të detajuara lidhur me projektet.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë “Albgaz” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 236, datë 2.11.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s, NR. 179, DATË 8.11.2017, “MBI CERTIFIKIMIN E SHOQËRISË OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR ‘ALBGAZ’ SHA”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 37, 50, 59, 68 dhe 80 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; të nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; të neneve 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të “Rregullores për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015 të Bordit të ERE-s dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 2.11.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179,

Faqe | 11146

datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror ‘Albgaz’ sh.a.”,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 179, datë 8.11.2017, certifikoi shoqërinë “Albgaz” sh.a. si operator i kombinuar i gazit natyror, në përputhje me nenet 37, 50, 59, 68 dhe 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe të nenin 9, pika 6, të direktivës 73/2009 EC.

Shoqëria “Albgaz” sh.a. nuk ka përmbushur kërkesat e vendimit sipërcituar, si vijon:

Pika 2. Brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi “Albgaz” sh.a. të zëvendësojë përfaqësuesit e MIE-s te Këshilli Mbikëqyrës i kompanisë me anëtarë të cilët nuk janë të punësuar te MIE ose te kompanitë e prodhimit dhe/ose të furnizimit të energjisë elektrike që kontrollohen nga ajo.

Pika 3. “Albgaz” të raportojë çdo muaj në ERE procedurën për regjistrimin e aseteve të transmetimit dhe ta përfundojë procedurën brenda gjashtë muajve pas miratimit të vendimit Përfundimtar.

Pika 4. Paragrafi “...”, si dhe duhet që të hartojë dhe t’i dorëzojë ERE-s, raportin e përcaktuar sipas programit të përputhshmërisë rregullatore, jo më vonë se 12 muaj nga miratimi i vendimit të certifikimit të “Albgaz” sh.a., konform përcaktimeve të nenit 21 të direktivës nr. 73/2009 të Komisionit Evropian, “Mbi rregullat për tregun e gazit natyror” dhe të nenit 47, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Pika 5. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për qëllime të implementimit të rekomandimeve në opinionin e sekretariatit, “Albgaz” sh.a. të paraqesë në ERE dëshmi që tregojnë garancinë, në lidhje me:

5.2 Bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, Neni 11 dhe 46 (10) i ligjit “Për sektorin e gazit natyror dhe transferimi i kompetencave te Ministria e Ekonomisë”. Për përmbushjen e këtij detyrimit, “Albgaz” sh.a. do t’i paraqesë ERE-s provat dokumentare që ndryshimet ligjore dhe nënligjore të nevojshme që lidhen me transferimin e kompetencave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë tek aksionari i “Albgaz” sh.a., Ministria e Ekonomisë dhe Financave, kanë ndodhur, janë efektive.



Pika 7. “Albgaz” sh.a. do të raportojë çdo 3 muaj në tek ERE dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të pikave 2, 3, 4 dhe 5 të këtij vendimi, si dhe me ecurinë e procesit të transferimit të kompetencave nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë te Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Në vijim të sa më sipër, shoqëria “Albgaz” sh.a., në pamundësi për të plotësuar kushtet e vendosura në vendimin ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 233/7 prot., datë 16.10.2018, ka kërkuar shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të parashikuara në vendimin nr. 179, datë 8.11.2017 deri në datën 10.4.2019 dhe bën me dije se po merr të gjitha masat e nevojshme për plotësimin e pikave të kërkuara në këtë vendim.

“Albgaz” sh.a. argumenton se shkak për mosplotësimin në kohë të kushteve të sipërpërmendura janë vonesat administrative nga institucionet e tjera, si: ZRPP, MIE etj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Afatet e përcaktuara në pikat 2, 3, 5, 5.2 dhe 7 të dispozitivit të vendimit nr. 179, datë 8.11.2018, “Mbi certifikimin e shoqërisë Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror ‘Albgaz’ sh.a.”, të shtyhen deri në datën 10.4.2019.

2. Afati i përcaktuar në pikën 4, paragrafi “...”, si dhe duhet që të hartojë dhe t’i dorëzojë ERE-s, raportin e përcaktuar sipas programit të përputhshmërisë rregullatore, jo më vonë se 12 muaj nga miratimi i vendimit të certifikimit të “Albgaz” sh.a., konform përcaktimeve të nenit 21 të direktivës nr. 73/2009 të Komisionit Evropian, “Mbi rregullat për tregun e gazit natyror” dhe të nenit 47 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, shtyhet deri në datën 10.4.2019.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut ta përcjellë këtë vendim pranë “Albgaz” sh.a., Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 237, datë 2.11.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E “PROPOZIMI I TË
GJITHA OST-ve PËR NJË
METODOLOGJI TË OFRIMIT TË TË
DHËNAVE TË GJENERIMIT DHE TË
NGARKESËS, NË PËRPUTHJE ME
NENIN 17 TË RREGULLORES SË
KOMISIONIT (BE) 2016/1719, TË DATËS
26 SHTATOR 2016, ‘PËR KRIJIMIN E NJË
UDHËZUESI MBI ALOKIMIN E
KAPACITETEVE NË AVANCË”**

Në mbështetje të neneve 7, 16, 56 dhe 63 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 19, pika 1, germa “P” dhe të nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.11.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit, në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, të datës 26 shtator 2016, ‘Për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë”

konstatoi se:

- OST sh.a., me shkresën nr. 7329 prot., datë 23.10.2018, ka përcjellë në ERE për miratim “Propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe të ngarkesës, në përputhje me nenin 17, të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, të datës 26 shtator 2016, ‘Për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë”.



- Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përkatësisht neni 56 dhe neni 63, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të miratuar me vendimin e ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, përkatësisht nenit 117, “Kërkesa të përgjithshme për shkëmbimin e të dhënave”, si dhe nenet 118 deri 130 të tij. Propozimi është përshtatur në shqip nga OST sh.a., në përputhje me nenin 19 të dokumentit origjinal.

- Dokumenti vjen nga OST sh.a. në vijim të komunikimit nr. 3886 prot., datë 25.5.2018, me objekt: “Propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit, në përputhje me nenin 18 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, të datës 26 shtator 2016, ‘Për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë’”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 20.8.2018 dhe është pjesë e të njëjtit kuadër metodologjik të Metodologjisë të Modelit të Përbashkët të Rrjetit, por i paraqitur dhe i propozuar për miratim si akt më vete.

- Dokumenti i përbërë nga 19 nene saktëson kërkesat në lidhje me dorëzimin e të dhënave të gjenerimit dhe të ngarkesës së nevojshme për të krijuar modelin e përbashkët nëpërmjet të cilit do të bëhet në nivel evropian, analiza e sigurisë, me qëllimin përcaktimin e kapaciteteve të lira në avancë, por edhe ato të ditës në avancë apo brenda ditës.

- Në përputhje me vendimin e marrë nga ENTSO-E dhe sipas udhëzimeve të përcjella, kjo metodologji do të zbatohet për të gjitha OST-të e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat do ta përcjellin për miratim te autoritetet respektive rregullatore. OST-të nga një shtet joanëtar i Bashkimit Evropian inkurajohen, gjithashtu, që ta përcjellin dokumentin pranë Autoritetit Rregullator, duke siguruar një përkthim të dokumentit së bashku me versionin në gjuhën angleze.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës, në përputhje me nenin 17, të Faqe|11148

Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, të datës 26 shtator 2016, ‘Për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë’” (bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht) ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit shqip.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit do të njoftojë palët e interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 238, datë 2.11.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E “PROPOZIMI I TË
GJITHA OST-ve PËR NJË
METODOLOGJI TË MODELIT TË
PËRBASHKËT TË RRJETIT, NË
PËRPUTHJE ME NENET 67 (1) DHE 70
(1), TË RREGULLORES SË KOMISIONIT
(BE) 2017/1485, TË DATËS 2 GUSHT 2017,
‘PËR KRIJIMIN E NJË UDHËZUESI MBI
OPERIMIN E SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 7, 16, 56 dhe 63, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 19, pika 1, germa “f” dhe të nenit 26, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 2.11.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit, në përputhje me nenet 67 (1) dhe 70 (1), të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485, të datës 2 gusht 2017, ‘Për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike’”,

konstatoi se:



- OST sh.a., me shkresën nr. 7136 prot., datë 15.10.2018, ka përcjellë në ERE për miratim, “Propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit, në përputhje me nenet 67 (1) dhe 70 (1), të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485, të datës 2 gusht 2017, ‘Për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike’”.

- Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përkatësisht nenet 56 dhe 63, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit, të miratuar me vendim të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, përkatësisht nenit 117, “Kërkesa të përgjithshme për shkëmbimin e të dhënave”, si dhe nenet 118 deri 130 të tij. Propozimi është përshtatur në shqip nga OST sh.a., në përputhje me nenin 25 të dokumentit original.

- Dokumenti vjen nga OST sh.a. në vijim të komunikimit nr. 3886 prot., datë 25.5.2018, me objekt “Propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit, në përputhje me nenin 18 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, të datës 26 shtator 2016, ‘Për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë’”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 20.8.2018 dhe është pjesë e të njëjtit kuadër metodologjik të Metodologjisë të Modelit të Përbashkët të Rrjetit, por i paraqitur dhe propozuar për miratim si akt më vete.

- Ky dokument është një propozim i përbashkët i krijuar nga të gjithë Operatorët e Sistemeve të Transmetimit, në lidhje me krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

- Dokumenti i përbërë nga 25 nene saktëson mënyrën e krijimit të modeleve individuale të rrjetit nga secili OST, të dhënat që duhet të përmbajnë modelet përfshi topologjinë, ngarkesën, gjenerimin, si dhe mënyrën e bashkimit të këtyre modeleve në një të vetëm, nëpërmjet të cilit do të bëhet në nivel evropian analiza e sigurisë, me qëllimin përcaktimin dhe eliminimin e kongestionëve, për operimin optimal të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike. Gjithashtu, dokumenti përcakton krijimin e një mjedisi të të dhënave të planifikimit operativ të ENTSO-E, i cili do të shërbejë si pikë referimi

ku të gjitha OST-të do të jenë të detyruara të vënë në dispozicion dhe të kenë mundësi të marrin informacionin e nevojshëm për krijimin e modeleve individuale të rrjetit.

- Në përputhje me vendimin e marrë nga ENTSO-E dhe sipas udhëzimeve të përcjella, kjo metodologji do të zbatohet për të gjitha OST-të e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian të cilat do ta përcjellin për miratim tek autoritetet respektive rregullatorë. OST-të nga një shtet joanëtar i Bashkimit Evropian inkurajohen, gjithashtu, që ta përcjellin dokumentin pranë Autoritetit Rregullator, duke siguruar një përkthim të dokumentit së bashku me versionin në gjuhën angleze.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit, në përputhje me nenet 67 (1) dhe 70 (1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485, të datës 2 gusht 2017, ‘Për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike’” (bashkë-lidhur këtij vendimi).

2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht) ka përparësi në rast mosdakordësie nga palët në interpretim të versionit shqip.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit do të njoftojë palët e interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 239, datë 2.11.2018

**MBI RISHIKIMIN E “RREGULLORES
PËR PROCEDURAT DHE AFATET PËR
DHËNIEN, MODIFIKIMIN,
TRANSFERIMIN, RINOVIMIN OSE
HEQJEN E LICENCEVE NË SEKTORIN
E ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 39, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 19, pika 1, germa “a” dhe të nenit 26, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.11.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përparës nga drejtoritë teknike në lidhje me rishikimin e “Rregullore për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, me vendimin nr. 109, datë 29.6.2016, ka miratuar “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Duke qenë se ligji i sipërcituar pësoi ndryshime me atë nr. 7/2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, sa i përket veprimtarisë së Operatorit të Tregut, si dhe çeljes së Bursës Shqiptare të Energjisë, ka lindur nevoja e reflektimit të këtyre ndryshimeve në përmbajtjen e “Rregullore për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Në këtë rregullore do të përfshihen edhe parashikimet e pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, si dhe pikës 8, të aneksit 2 të tij, në të cilat parashikohet respektivisht, se:

- “8. Modeli i tregut të organizuar, siç është përcaktuar në këtë tekst, do të jetë i aplikueshëm në momentin e fillimit të punës së Bursës Shqiptare të Energjisë.”.

- “Aneksi 2, pika 8. Ministri përgjegjës për energjinë bashkëpunon me ERE-n, si dhe me ministrinë dhe institucionet e tjera publike për krijimin e Bursës Shqiptare të Energjisë. Ministria do të koordinojë hapat e nevojshëm edhe me Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, IFC-në dhe institucionet e tjera ndërkombëtare financiare.”.

- **Ndryshimet e propozuara janë si më poshtë:**

- Kudo në rregullore do të zëvendësohet termi “*aktivitet*” me atë “*veprimtari*” në zbatim të terminologjisë së përdorur në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Kudo në rregullore pas fjalëve “ligjit nr. 43/2015. “Për sektorin e energjisë elektrike”, do të shtohet fjala “i ndryshuar”.

- **Në nenin 4, “Licencat”,** në pikën 1 do të shtohet germa “h” me përmbajtje: “Tregun e organizuar të energjisë elektrike (Bursa Shqiptare e Energjisë), në zbatim të pikës 3.5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”.

Po në këtë nen, pas pikës 2 do të shtohet pika 3, me përmbajtje si më poshtë:

“3. Për atë që lejon legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë, nuk do të kërkohej licencë për tregtimin e energjisë elektrike ose furnizimin me energji elektrike, në rast se një shoqëri ka një licencë të lëshuar nga një autoritet rregullator i një vendi tjetër me të cilin është nënshkruar një marrëveshje dypalëshe, për njohjen reciproke të licencave ndërmjet ERE-s dhe autoritetit përkatës rregullator. Si dhe, me kusht që ato të dorëzojnë në ERE informacionin e përcaktuar në nenin 9 (1) të këtyre rregullave.”.

Sa më sipër shtohet në rregullore në vijim të Rekomandimit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe Memorandumit të Bashkëpunimit

Dhe pika 3, me përmbajtje: “Këto subjekte, në çdo rast janë të detyruara të respektojnë Modelin e Tregut, Rregullat e Tregut dhe Kodet e Rrjetit.”, bëhet pika 4.

- **Në nenin 5, “Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e licencës”,** është shtuar pika 2, me përmbajtje:

“2. Për aplikimet në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të cilat paraqiten në ERE më vonë se



data efektive e kontratës, llogaritja e afatit të licencimit, bëhet për periudhën e mbetur. Ky rregull vlen edhe për rastet e modifikimit të licencave.”.

- **Neni 8, “Paraqitja e aplikimit”,** do të riformulohet si vijon:

“1. Aplikimi konsiston në plotësimin e formatit të aplikimit dhe të dokumentacionit që përcaktohet në nenin 9 të kësaj rregulloreje, të plotësuar nga aplikuesi sipas objektivit të veprimtarisë për të cilin kërkohet të licencohet.

2. Aplikuesi, në momentin e paraqitjes së kërkesës për licencë, duhet të paraqesë bashkëlidhur dokumenteve të aplikimit, vërtetimin e pagesës së aplikimit, referuar aneksit A të kësaj rregulloreje. Moskryerja e kësaj pagese përbën shkak për mospranimin e aplikimit nga ana e ERE-s.

3. Dokumentacioni i aplikimit, i paraqitur nga aplikuesi duhet të jetë në gjuhën shqipe. Ai duhet të përcillet të ERE në origjinal ose në fotokopje të noterizuar dhe një kopje elektronike në CD. Të gjitha vërtetimet dhe deklaratat e lëshuara nga organe e tjera, për t’i shërbyer aplikimit duhet të jenë lëshuar jo më parë se 3 muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit.

4. Nëse aplikuesi ka aplikuar dhe është në proces për marrjen e lejeve të tjera të nevojshme të përcaktuara në rregullore, mund të paraqesë aplikimin në ERE, duke paraqitur informacion të shoqëruar me dokumentacionin justifikues, të lëshuar nga institucioni përkatës për fazën në të cilën ndodhet procesi i marrjes së lejeve nga institucionet e tjera.

5. Dokumentacioni teknik sipas tipit të licencës duhet të jetë i hartuar dhe i sigluar nga ekspertë të licencuar (ing. elektrik, ing. ndërtimi, ing. mekanik, ekspertë kontabël, ing. hidroteknik etj.)

(Pjesët e nënvizuara pasqyrojnë shtesat në këtë nen.)

6. Pika 6 e nenit 8 hiqet dhe pika 7 merr numërtimin 6.

- **Në nenin 9, “Formati dhe dokumentacioni për aplikim”,** është shtuar tek “Tipat e licencave” edhe Bursa e Energjisë, në zbatim të pikës 3.5, germa “h” dhe 4.5, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”.”.

- Në këtë format aplikimi, do të shtohen edhe te pika “Mbi modifikimin e licencave” për të reflektuar në tabelë sasitë e energjisë që kërkohet të modifikohen me modelin: “ishte”: dhe “bëhet”:

- Në nenin 9, pika 2, “Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor”, në germën “b”, pas fjalës “statuti”, shtohet: “Statuti “... nëse është hartuar si dokument i ndryshëm/i veçantë nga akti i themelimit.”.

- Në nenin 9, pika 2, “Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor”, në germën “e” zëvendësohen fjalët “Struktura e ndërtimit dhe e funksionimit administrativ të shoqërisë” me fjalën “Organigrama”.

- Në nenin 9, pika 2, “Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor”, në germën “f”, pas fjalës “autorizimi”, shtohen fjalët “... i lëshuar nga ministria përgjegjëse ...”.

- Në nenin 9, pika 2, “Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor”, në germën “g”, pas fjalës “me subjekte” shtohen fjalët “... private ose shtetërore ...”.

- Në nenin 9, pika 3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal, germa “d”, riformulohet si vijon: “Vërtetimi i kryerjes së pagesës së regjistrimit për aplikim në llogari të ERE-s, sipas aneksit A të kësaj rregulloreje.”.

- Në nenin 9, pika 4.1.3, “Dokumentacioni teknik dhe grafik”, germa “d”, pas fjalës “transmetuese” shtohen fjalët “... të energjisë ...”.

- Në nenin 9, pika 4.1.4, “Dokumentacioni tekniko ekonomik”, pas germës “c”, “Oponenca teknike e projektit”, shtohet germa “d”, me përmbajtje: “Miratimi nga Komiteti Kombëtar i Digave”;

- Në nenin 9, pika 4.1.5, “Lejet nga institucione të tjera”, fjala “përdorimit” zëvendësohet me fjalën “... shfrytëzimit ...”.

- Në nenin 9, pika 4.3, titulli “Dokumentacioni teknik për centrale eolike” zëvendësohet me titullin “Dokumentacioni teknik i centraleve për prodhimin e energjisë elektrike nga era”, sipas parashikimeve të ligjit 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

- Në nenin 9, pika 4.4, titulli “Dokumentacioni teknik për centrale solare” zëvendësohet me titullin “Dokumentacioni teknik i centraleve për prodhimin e energjisë elektrike nga dielli (fotovoltaike)”, sipas parashikimeve të ligjit 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

- Në nenin 9, pika 4.4.1, titulli “Të dhënat teknike për centralet solare”, zëvendësohet me titullin “Të dhëna teknike të centraleve për prodhimin e energjisë elektrike nga dielli (fotovoltaike)”.



- Po k^ëtu 4.4.1, n^ë tabel^ë, hiqet fjala “*solare termike*”, pasi nuk *është* n^ë fush^{ën} e veprimtaris^ë s^ë ERE-s t^ë licencoj^ë apo merret me tipa t^ë till^ë objektesh/centralesh.

- N^ë nenin 9, pika 4.4.4, “Dokumentacioni tekniko-ekonomik (p^{ër} fotovoltaike^t), n^ë germ^{ën} “c”, pas fjal^{ës} “*projektit ...*” shtohen fjal^{ët} “*e kryer nga AKBN-ja ose nga n^{jë} subjekt privat i licencuar*”.

- N^ë nenin 9, pika 4.7, “Dokumentacioni teknik p^{ër} veprimtarin^ë e furnizimit t^ë energjis^ë elektrike”, germa “b” riformulohet si vijon: “*Kapitali financiar (i shprehur n^ë vlera monetare) i parashikuar p^{ër} ushtrimin e k^{ësaj} veprimtarie, i shoq^ëruar me v^ërtetim nga banka.*”. Dhe shtohet germa “g”, me p^{ër}mbajtje si vijon: “*Dokumentacion q^ë v^ërteton aft^ësin^ë e disponimit t^ë zyrave p^{ër}faq^{ës}uese t^ë furnizuesit, p^{ër} sh^ërbimet q^ë do t’u ofrohen klient^{ëve}.*”.

- N^ë nenin 9, pika 4.7, tabela “a”, “T^ë dh^ëna p^{ër} klient^{ët} dhe energjin^ë e furnizuar”, merr num^ërtimin 4.8 dhe vijon rregullimi i num^ërtimit edhe m^ë pikat e tjera m^ë posht^ë, n^ë vijim t^ë saj, pasi p^ërs^ëriteshin dy her^ë “*numbering*” brenda pik^{ës} 4.7, duke krijuar konfuzion n^ë p^{ër}mbajtjen e nenit ...

- N^ë nenin 9, pika 4.7, germa “c”, tashm^ë me num^ërtimin e ri pika 4.8, germa “c”, hiqet pasi krijon p^ërs^ëritje.

- N^ë nenin 9, pika 4.9, me num^ërtimin e ri, “Dokumentacioni teknik p^{ër} veprimtarin^ë e tregtimit t^ë energjis^ë elektrike”, germa “b” riformulohet si m^ë posht^ë: “*Kapitali financiar (i shprehur n^ë vlera monetare) i parashikuar p^{ër} ushtrimin e k^{ësaj} veprimtarie, i shoq^ëruar me v^ërtetim nga banka.*”.

- N^ë nenin 9, pas pik^{ës} 4.10 me num^ërtimin e ri, shtohet pika 4.11 me p^{ër}mbajtje si vijon:

“4.11 Dokumentacioni teknik p^{ër} licencimin burs^{ës} s^ë energjis^ë:

a) Lista e t^ë pun^{ës}uarve, profesioni, formimi;

b) D^{ësh}mi p^{ër} posedimin e *hardverit* dhe t^ë *softverit* t^ë nevojsh^{ëm} p^{ër} komunikimin me t^ë gjitha pikat e matjes, si dhe me t^ë gjith^ë pjes^{ëm}arr^{ës}it n^ë treg, burs^ë dhe p^{ër} operimin e burs^{ës};

c) Lista e an^ëtar^{ëve} t^ë K^{ësh}illit Mbik^ëqyr^{ës}.”.

Sa i p^{ër}ket k^{ësaj} shtese, ndoshta do t^ë duhet t^ë b^ëhen edhe plot^ësime t^ë tjera pas fillimit t^ë procedur^{ës}, pasi mungesa e eksperienc^{ës} son^ë n^ë

licencimin e bursave k^{ër}kon n^{jë} asistenc^ë t^ë kualifikuar si ajo e Bank^{ës} Bot^ërore dhe USAID-it.

- N^ë nenin 10, “Shqyrtimi i aplikimit”, n^ë pik^{ën} 7 pas fjal^{ëve} “... *aplikimin e ri ...*” shtohen fjal^{ët} “... *i shoq^ëruar me pages^{ën} e aplikimit ...*”.

- N^ë nenin 10, “Shqyrtimi i aplikimit”, n^ë pik^{ën} 8, pas fjal^{ëve} “*dy dit^ë me radh^ë njoftimin p^{ër} ...*” hiqen fjal^{ët} “*aplikimin e paraqitur*” dhe shtohen fjal^{ët} “*fillimin e procedur^{ës} s^ë shqyrtimit t^ë aplikimit*”.

- N^ë nenin 14, “Pranimi ose refuzimi p^{ër} licencim i aplikuesit”, n^ë pik^{ën} 1, pas fjal^{ës} “*prodhimit*” shtohen fjal^{ët} “*t^ë energjis^ë elektrike*”.

- N^ë nenin 15, “Modifikimi i licenc^{ës}”, pika 4, germa “e”, riformulohet si vijon: “*T^ë ket^ë kryer pagesat e aplikimit dhe t^ë rregullimit n^ë ERE*”.

- N^ë nenin 16, “Rinovimi i licenc^{ës}”, n^ë pik^{ën} 7, pas fjal^{ës} “*pages^{ën}*” shtohen fjal^{ët} “*e aplikimit dhe at^ë ...*”.

- N^ë nenin 17, “Transferimi i plot^ë dhe i pjessh^{ëm} i licenc^{ës}”, pika 4, n^ë fillim t^ë fjalis^ë s^ë pik^{ës} 4 shtohet: “*N^ë rastin e k^{ër}kes^{ës} nga i licencuari p^{ër} transferimin e licenc^{ës} ...*” dhe shtohet germa “e” n^ë pik^{ën} 4, t^ë nenit 17, me p^{ër}mbajtje: “*e) V^ërtetimin e pages^{ës} s^ë aplikimit.*”.

- Neni 18, “Heqja e licencave”, riformulohet si vijon: “Me iniciativ^ë t^ë ERE-s, personave t^ë interesuar apo mbajt^{ës}it e licenc^{ës}, si dhe n^ë zbatim t^ë n^{jë} vendimi gjykate, ERE fillon procedur^{ën} p^{ër} heqjen e licenc^{ës} n^ë zbatim t^ë parashikimeve t^ë rregullores p^{ër} procedurat e heqjes s^ë n^{jë} licence t^ë miratuar nga Bordi i ERE-s. (Pjes^{ët} e n^ënvizuara pasqyrojn^ë shtesat n^ë ket^ë nen.)”.

- Neni 20, “E drejta p^{ër} t’u informuar mbi p^{ër}mbajtjen e regjistrit”, pika 1 riformulohet si vijon: “1. Regjistri i licencave publikohet n^ë faqen e web-it t^ë ERE-s”.

- N^ë nenin 22, titulli “Amendamente t^ë rregullores” z^ëvend^ësohet me “Amendimi i rregullores”.

- N^ë aneksin A, “Pagesa e regjistrimit dhe e procedimit t^ë n^{jë} aplikimi”, shtohet edhe “Tregun e organizuar t^ë energjis^ë elektrike (Bursa Shqiptare e Energjis^ë)”. Pagesat u plot^ësuan t^ë unifikuara me ato t^ë veprimtaris^ë s^ë Operimit t^ë Sistemit t^ë Transmetimit.

P^{ër} gjith^ë sa m^ë sip^{ër} cituar, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për rishikimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 109, datë 29.6.2016.

2. Ndryshimet në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” gjenden bashkëlidhur këtij vendimi

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

**NDRYSHIMET NË “RREGULLOREN
PËR PROCEDURAT DHE AFATET PËR
DHËNIEN, MODIFIKIMIN,
TRANSFERIMIN, RINOVIMIN OSE
HEQJEN E LICENCAVE NË SEKTORIN
E ENERGJISË ELEKTRIKE”**

- Kudo në rregullore do të zëvendësohet termi “aktivitet” me atë “veprimtari”

- Kudo në rregullore pas fjalëve, “ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, do të shtohet fjala “i ndryshuar”.

- Në nenin 4, “Licencat”, në pikën 1 do të shtohet germa “h”, me përmbajtje “Tregun e organizuar të energjisë elektrike (Bursa Shqiptare e Energjisë)”.

Po në këtë nen pas pikës 2 do të shtohet pika 3, me përmbajtje si më poshtë:

“4. Për atë që ka të drejtë të legjislativë në fuqi i Republikës së Shqipërisë, nuk do të kërkohej licencë për tregtimin e energjisë elektrike ose për furnizimin me energji elektrike, në rast se një shoqëri ka një licencë të lëshuar nga një autoritet rregullator i një vendi tjetër, me të cilin është nënshkruar një marrëveshje dypalëshe, për njohjen reciproke të licencave ndërmjet ERE-s

dhe autoritetit përkatës rregullator. Si dhe, me kusht që ato të dorëzojnë në ERE informacionin e përcaktuar në nenin 9 (1) të këtyre rregullave.”.

Dhe pika 3, me përmbajtje: “Këto subjekte, në çdo rast janë të detyruara të respektojnë Modelin e Tregut, Rregullat e Tregut dhe Kodet e Rrjetit.”, bëhet pika 4.

- Në nenin 5, “Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e licencës”, është shtuar pika 2, me përmbajtje:

“2. Për aplikimet në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të cilat paraqiten në ERE më vonë se data efektive e kontratës, llogaritja e afatit të licencimit, bëhet për periudhën e mbetur. Ky rregull vlen edhe për rastet e modifikimit të licencave.”.

- Neni 8, “Paraqitja e aplikimit”, do të riformulohet si vijon:

“7. Aplikimi konsiston në plotësimin e formatit të aplikimit dhe dokumentacionit që përcaktohet në nenin 9 të kësaj rregulloreje, të plotësuar nga aplikuesi, sipas objektivit të veprimtarisë për të cilën kërkon të licencohet.

8. Aplikuesi, në momentin e paraqitjes së kërkesës për licencë, duhet të paraqesë bashkëlidhur dokumenteve të aplikimit, vërtetimin e pagesës së aplikimit referuar aneksit A të kësaj rregulloreje. Moskryerja e kësaj pagese përbën shkak për mospranimin e aplikimit nga ana e ERE-s.

9. Dokumentacioni i aplikimit, i paraqitur nga aplikuesi, duhet të jetë në gjuhën shqipe. Ai duhet të përcillet të ERE në origjinal ose fotokopje të noterizuar dhe një kopje elektronike në CD. Të gjitha vërtetimet dhe deklaratat e lëshuara nga organe të tjera, për t'i shërbyer aplikimit duhet të jenë lëshuar jo më parë se 3 muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit.

10. Nëse aplikuesi ka aplikuar dhe është në proces për marrjen e lejeve të tjera të nevojshme të përcaktuara në rregullore, mund të paraqesë aplikimin në ERE, duke paraqitur informacion të shoqëruar me dokumentacionin justifikues, të lëshuar nga institucioni përkatës për fazën në të cilën ndodhet procesi i marrjes së lejeve nga institucionet e tjera.

11. Dokumentacioni teknik, sipas tipit të licencës, duhet të jetë i hartuar dhe i sigluar nga ekspertë të licencuar (ing. elektrik, ing. ndërtimi, ing. mekanik, ekspertë kontabël, ing. hidroteknik etj.).

(Pjesët e nënvizuara pasqyrojnë shtesat në këtë nen.)

12. Pika 6 e nenit 8 hiqet dhe pika 7 merr numërtimin 6.



- Në nenin 9, “Formati dhe dokumentacioni për aplikim”, është shtuar te “Tipat e licencave” edhe “Bursa e Energjisë”,

- Në këtë format aplikimi do të shtohen edhe të pika “Mbi modifikimin e licencave” për të reflektuar në tabelë sasitë e energjisë që kërkohen të modifikohen me modelin: “ishte”: dhe “bëhet”.

- Në nenin 9, pika 2, “Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor”, në germën “b”, pas fjalës statuti, shtohet: Statuti “... nëse është hartuar si dokument i ndryshëm/i veçantë nga akti i themelimit.”.

- Në nenin 9, pika 2, “Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor”, në germën “e”, zëvendësohen fjalët “Struktura e ndërtimit dhe e funksionimit administrativ të shoqërisë”, me fjalën “Organigrama”.

- Në nenin 9, pika 2, “Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor”, në germën “f”, pas fjalës “autorizimi” shtohen fjalët “... i lëshuar nga ministria përgjegjëse ...”.

- Në nenin 9, pika 2, “Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor”, në germën “g”, pas fjalës “me subjekte” shtohen fjalët “... private ose shtetërore ...”.

- Në nenin 9, pika 3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”, germa “d” riformulohet si vijon: “Vërtetimi i kryerjes së pagesës së regjistrimit për aplikim në llogari të ERE-s, sipas aneksit A të kësaj rregulloreje.”.

- Në nenin 9, pika 4.1.3, “Dokumentacioni teknik dhe grafik”, germa “d”, pas fjalës “transmetuese” shtohet fjala “... të energjisë ...”.

- Në nenin 9, pika 4.1.4, “Dokumentacioni tekniko-ekonomik”, pas germës “c”, “Oponenca teknike e projektit”, shtohet germa “d”, me përmbajtje: “Miratimi nga Komiteti Kombëtar i Digave”.

- Në nenin 9, pika 4.1.5, “Lejet nga institucione të tjera”, fjala “përdorimit” zëvendësohet me fjalën “... shfrytëzimit ...”.

- Në nenin 9, pika 4.3, titulli “Dokumentacioni teknik për centrale eolike” zëvendësohet me titullin “Dokumentacioni teknik i centraleve për prodhimin e energjisë elektrike nga era”.

- Në nenin 9, pika 4.4, titulli “Dokumentacioni teknik për centrale solare” zëvendësohet me titullin “Dokumentacioni teknik i centraleve për prodhimin e energjisë elektrike nga dielli (fotovoltaike)”.

- Në nenin 9, pika 4.4.1, titulli “Të dhënat teknike për centrale solare” zëvendësohet me titullin “Të dhëna teknike të centraleve për prodhimin e energjisë elektrike nga dielli (fotovoltaike)”.

- Po këtu, 4.4.1 në tabelë, hiqet fjala “solare termike”, pasi nuk është në fushën e veprimtarisë së ERE-s të licencojë apo të merret me tipa të tillë objektsh/centralesh.

- Në nenin 9, pika 4.4.4 “Dokumentacioni tekniko-ekonomik” (për fotovoltaikët), në germën “c”, pas fjalës “projektit ...” shtohen fjalët “e kryer nga AKBN-ja ose nga një subjekt privat i licencuar”.

- Në nenin 9, pika 4.7, “Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, germa “b” riformulohet si vijon: “Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka.”. Dhe shtohet germa “g”, me përmbajtje si vijon: “Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’u ofrohen klientëve.”.

- Në nenin 9, pika 4.7, tabela “a”, “Të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar”, merr numërtimin 4.8 dhe vijon rregullimi i numërtimit edhe me pikat e tjera më poshtë, në vijim të saj.

- Në nenin 9, pika 4.7, germa “c”, tashmë me numërtimin e ri, pika 4.8, germa “c”, hiqet.

- Në nenin 9, pika 4.9, me numërtimin e ri, “Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, germa “b” riformulohet si më poshtë: “Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka.”.

- Në nenin 9, pas pikës 4.10 me numërtimin e ri, shtohet pika 4.11 me përmbajtje si vijon:

“4.11 Dokumentacioni teknik për licencimin Bursës së Energjisë:

a) Lista e të punësuarve, profesioni, formimi;

b) Dëshmi për posedimin e *hardverit* dhe të të *softverit* të nevojshëm për komunikimin me të gjitha pikat e matjes, si dhe me të gjithë pjesëmarrësit në treg, bursë dhe për operimin e bursës.

c) Lista e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.”.



- Në nenin 10, “Shqyrtimi i aplikimit”, në pikën 7, pas fjalëve “... aplikimin e ri ...” shtohen fjalët “... i shoqëruar me pagesën e aplikimit ...”.

- Në nenin 10, “Shqyrtimi i aplikimit”, në pikën 8, pas fjalëve “dy ditë me radhë njoftimin për ...” hiqen fjalët “aplikimin e paraqitur” dhe shtohen fjalët “fillimin e procedurës së shqyrtimit të aplikimit”.

- Në nenin 14, “Pranimi ose refuzimi për licencim i aplikuesit”, në pikën 1, pas fjalës “prodhimit” shtohen fjalët “të energjisë elektrike”.

- Në nenin 15, “Modifikimi i licencës”, pika 4, germa “e”, riformulohet si vijon: “Të ketë kryer pagesat e aplikimit dhe të rregullimit në ERE.”

- Në nenin 16, “Rinovimi i licencës”, në pikën 7, pas fjalës “pagesën” shtohen fjalët “e aplikimit dhe atë ...”

- Në nenin 17, “Transferimi i plotë dhe i pjesshëm i licencës”, pika 4, në fillim të fjalisë së pikës 4 shtohet: “Në rastin e kërkesës nga i licencuari për transferimin e licencës ...” dhe shtohet germa “e” në pikën 4, të nenit 17, me përmbajtje: “e) Vërtetimin e pagesës së aplikimit.”

- Neni 18 “Heqja e licencave”, riformulohet si vijon: Me iniciativë të ERE-s, personave të interesuar apo mbajtësit të licencës, si dhe në zbatim të një vendimi gjykate, ERE fillon procedurën për heqjen e licencës, në zbatim të parashikimeve të rregullores për procedurat e heqjes së një licence të miratuar nga Bordi i ERE-s. (Pjesët e nënvizuara pasqyrojnë shtesat në këtë nen.)

- Neni 20 “E drejta për t’u informuar mbi përmbajtjen e regjistrit”, pika 1 riformulohet si vijon: “1. Regjistri i licencave publikohet në faqen e web-it të ERE-s.”

- Në nenin 22, titulli “Amendamente të rregullores” zëvendësohet me “Amendimi i rregullores”

- Në aneksin A, “Pagesa e regjistrimit dhe e procedimit të një aplikimi”, shtohet edhe “Tregun e organizuar të energjisë elektrike (Bursa Shqiptare e Energjisë)”.

VENDIM

Nr. 240, datë 2.11.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ReNRGY TRADING GROUP” SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, germa “d”; të nenit 5, pika 1 germa “d”; të nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016 dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.11.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. nr. 684 prot., datë 23.10.2018, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1.): plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2): plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, pika 4.7.1): plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Nr. 9287/11, datë 12.11.2018

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti, “Ndërtimi i rrugës që lidh rrugën ‘Don Bosko’ me rrugën ‘Egnatia’”, Tiranë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për llogaritjen e vlerës së truallit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 3 496 528 lekë (tre milionë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e njëzetë e tetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli



TABELA PARAPRAKE E PRONARËVE, PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT
“NDËRTIMI I RRUGËS QË LIDH RRUGËN ‘DON BOSKO’ ME RRUGËN ‘EGNATIA’”, TIRANË

Shënim. Çmimet për truallin janë marrë në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	ZK	Nr. i pasurisë	Sip. totale truall (m ²)	Sip. truallit i prekur (m ²)	Çmimi i truallit, lekë/m ²	Sip. obj. e prekur (m ²)	Çmimi obj. lekë/m ²	Vlera në lekë	Shënime në kartelë/ pjesët takuese
1	Vladimir Pjetërgjokaj	Truall	8310	6/922	399.1	19	31219			593161	
2	Skënder Pahumi	Truall	8310	6/923	207.9	17	31219			530723	
3	Mirjana Pahumi Besmir Pahumi Nertila Pahumi	Truall	8310	6/924	216.9	4	31219			124876	Mirjana Ahmet Pahuni 1/3 B, Besmir Avni Pahuni 1/3 B, Nertila Avni Pahuni 1/3 B
4	Lulzim Kalbaj	Truall	8310	6/624	288	4	31219			124876	
5	Blerim Feim Shqiponja Feim Sherif Shqiponja	Truall	8310	6/620	248.1	18	31219			561942	Blerim Feim Shqiponja 1/2 B, Feim Sherif Shqiponja 1/2 B. Përshkrim i veçantë: Godinë banimi 3 kate B
6	Niko Bengu Gëzim Sherif Shqiponja Sali Ismail Zaimi	Truall	8310	6/927	266.3	21	31219			655599	Niko Shefki Bengu 1/3 B, Gëzim Sherif Shqiponja 1/3 B, Sali Ismail Zaimi 1/3 B
7	Viktor Marku Zef Qarraj	Truall	8310	6/928	262	22	31219			686818	Viktor Gjon Marku 1/2 B, Zef Gjon Qarraj 1/2 B
8	Luk Kalaj, Katrine Kalaj, Tom Kalaj, Gasper Kalaj	Truall	8310	6/929	145.3	7	31219			218533	Luk Ded Kalaj 1/4 B, Katrine Gjergj Kalaj 1/4 B, Tom Ded Kalaj 1/4 B, Gasper Ded Kalaj 1/4 B
9	SHTET	Rrugë	8310	6/1085	573	8	31219			0	
10	SHTET	Trotuar	8310	6/1086	27.9	3	31219			0	
11	SHTET	Truall	8310	6/1157	95	52	31219			0	Sek. e kartelës: Kjo pasuri është e okupuar nga Agim Nurçja dhe ka një ndërtim të paligjshëm
12	SHTET	Rrugë	8310	6/18	1,287.2	1287	31219			0	Përshkrimi i veçantë: Shtohet sip. prej 16.1 m ² (ref. 13219)
13	SHTET	Rrugë	8310	6/107	8134	16	31219			0	
14	SHTET	Shesh	8310	6/39	417	25	31219			0	
15	SHTET	Trotuar	8310	6/1094	351	8	31219			0	
16	SHTET	Truall	8310	6/32	264.7	5	31219			0	Sek. e kartelës: Kjo pasuri është e okupuar nga Agron Turja dhe ka një ndërtim të paligjshëm
17	SHTET	Truall	8310	6/33	242.5	10	31219			0	Sek. e kartelës: Kjo pasuri është e okupuar nga Hamza Kallaveria dhe ka një ndërtim të paligjshëm
18	SHTET	Rrugë	8310	6/1087	196.2	2	31219			0	
19	SHTET	Rrugë	8310	6/1080	962.4	660	31219			0	
Vlera totale paraprake						2188				3496528	

**KËRKESË****Nr. 9954/5, datë 12.11.2018****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti, “Rikualifikim urban i sheshit në fshatin Samaticë”, Ura Vajguore.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Bashkia Ura Vajguore.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim,

që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për llogaritjen e vlerës së tokës “Arë”, për pronarin sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 206,000 lekë (dyqind e gjashtë mijë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

TABELA PARAPRAKE E PRONARËVE, PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “RIKUALIFIKIM URBAN I SHESHIT
NË FSHATIN SAMATICË”, URA VAJGUORE

Shënim. Çmimi për tokën “arë” është marrë në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	ZK	Nr. i pasurisë	Sip. totale (m ²)	Sip. e prekur (m ²)	Çmimi lekë/m ² , njësi	Sip. obj. e prekur (m ²)	Çmimi obj., lekë/m ²	Vlera në lekë	Konfirmuar ZRPP, Berat
1	Xhemal Dylja	Arë	3256	16/37	1000		206			206.000 lekë	Po
TOTALI					1000					206.000 lekë	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 420 lekë